

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.2 (356)

SHKURT 2018

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

## HISTORIA



## Si i morën austriakët armët e Skënderbeut

Njoftimet për armët e Skënderbeut i kemi në dy rrugë: nga burime të shkruara dhe nga vetë armët që kanë arritur deri në ditët tona

Nga Kristo FRASHËRI

FAQE 4

## INTERVISTA



## Parllaku: Nuk mund të ketë luftë civile kur ke okupatorin brenda

"Përgjegjës për masakrën e Tivarit janë Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe që e kanë ditur planin e jugosllavëve.

FAQE 5

## HISTORIA



## Gjeneral brigade Manushaqe Shehu emërohet zëvendës shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA

FAQE 12

## SFIDA E SHTETFORMIMIT

Halil RAMA

Dhjetë vite të shtetit dhe pavarësisë së Kosovës dhe 19 vite të çlirimit (lirisë së saj) nga sundimi i bandës serbe të Millosheviçit janë një bilanc arritjesh të konsiderueshme, por edhe të sfidës së shtetformimit.

Dhjetë vite të pavarësisë së Kosovës nuk kanë qenë vite të lehta. Vështirësi të shumta kanë sfiduar udhën e saj drejt projektit të shtetformimit. Por pjekuria e durimi, forca e mençuria, besimi i pashterë të liria, respekti fisnik ndaj tipareve më të vjera kombëtare me të cilat lidershipi kosovar ka përballuar këto sfida do të shkruhen në faqen e krenarisë sonë kombëtare.

Gjithsesi, problematikat janë të mprehta e serioze. Megjithë dialogun e pandërprerë me Beogradin, nën monitorimin dhe ndërmjetësimin e BE e SHBA, progresin dhe regresin e këtij dialogu në momente delikate, ende kosovarët janë të vetmit në Ballkan që nuk gëzojnë lëvizjen e lirë pa viza në vendet e BE. Kushtëzimi nga kancelaritë perëndimore me krijimin e të ashtuquajturës Gjykatë Speciale,

(Vijon ne faqen 2)

## PROFIL

## KUR DEDE QAFËN E THIRRI "ZANI I TË PARËVE TË TIJ"

Nga Xhemal Meçi

FAQE 9

## LIBRI

## "BURRI FISNIK MARK QERIMI", NJË MONOGRAFI ME VLERA

Dr.Nikollë Loka

FAQE 10

## KUVENDI

## ANGAZHIM KONKRET NË MBROJTJE TË VLERAVE TË LANÇ



Nga Bashkim Hisari

FAQE 7



## SHQIPËRI – TURQI: Bashkëpunim dypalësh në industrinë ushtarake dhe të mbrojtjes



FAQE 12

## NDERIMI

## Kosova përkujton Presidentin, 12 vjet pa Ibrahim Rugovën

FAQE 12

Nderim për të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrificë të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën

# Kosovë e Pavarur

## MESAZHI

## OBLV, mesazh urimi për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës



FAQE 2

## HOMAZH

## ERNEST JAJOVA - hartuesi i studimeve bashkëkohore ushtarake

FAQE 6

## LAMTUMIRË VANGJEL KOKERI

Nga Myfit GUXHOLLI

FAQE 7

## LIBRI

## RAMIZ REKA – MJESHTRI DHE TEORICIENI I BOKSIT



SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 8

## Kosova, shtet i pavarur njihet zyrtarisht nga 115 shtete

Ndër këto janë 24 prej 28 shteteve të Bashkimit Evropian si dhe SHBA

FAQE 3





## DEKLARATA

*Nderim për të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën*

# 10 vjet Kosovë e Pavarur!

**Më 17 shkurt të vitit 2008 Kosova u bë shtet i pavarur. Më 17 shkurt të vitit 2018 bëhen dhjetë vjet që shqiptarët përtej kufirit tonë, festojnë shtetësinë. Me këtë rast publikojmë edhe njëherë Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.**

Të mbledhur në mbledhje të jashtëzakonshme më 17 shkurt 2008, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë,

Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afirmon krenarinë dhe synimet e qytetarëve të saj,

Të zotuar për t'u përballur më trashëgiminë e dhembshme të së kaluarës së afërt në frymë të pajtimit dhe faljes,

Të përkushtuar ndaj mbrojtjes, promovimit dhe respektimit të diversitetit të popullit tonë,

Duke riafirmuar dëshirën tonë për t'u integruar plotësisht në familjen euroatlantike të demokracive,

Duke vërejtur se Kosova është një rast special që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është presedan për cilëndo situatë tjetër,

Duke rikujtuar vitet e konfliktit dhe dhunës në Kosovë që shqetësuan ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar,

Mirënjohës që bota intervenoi më 1999 duke hequr në këtë mënyrë qeverisjen e Beogradit mbi Kosovën, dhe vendosur Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara,

Krenarë që Kosova që atëherë ka zhvilluar institucione funksionale, multietnike të demokracisë që shprehin lirisht vullnetin e qytetarëve tanë,

Duke rikujtuar vitet e negociatave të sponsorizuara ndërkombëtarisht ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mbi çështjen e statusit tonë të ardhshëm politik,

Duke shprehur keqardhje që nuk u arrit asnjë rezultat i pranueshëm për të dyja palët përkundër angazhimit të mirëfilltë të udhëheqësve tanë,

Duke konfirmuar se rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, i ofrojnë Kosovës një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e saj të ardhshëm, dhe janë në vijë me standardet më të larta europiane për të drejtat të njeriut dhe qeverisjen e mirë,

Të vendosur që ta shohim statusin tonë të zgjidhur në mënyrë që t'i jipet popullit tonë qartësi mbi të ardhmen e vet, të shkohet përtej konflikteve të së



kaluarës dhe të realizohet potenciali i plotë demokratik i shoqërisë sonë,

Duke nderuar të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën,

Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmblajtura në Planin e Ahtisaarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Ne do të miratojmë sa më shpejt që të jetë e mundur një kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definohen me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe

do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.

Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).

Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Europian. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në pranimë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë.

Për arsye të kulturës, gjeografisë dhe historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen europiane. Për këtë arsye, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin Europian sapo që të jetë e mundur dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim europian dhe euroatlantik.

Ne i shprehim mirënjohje Organizatës së Kombeve të Bashkuara për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas lufte dhe ndërtimin e institucioneve të demokracisë. Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me Organizatën e Kombeve të Bashkuara gjersa ajo vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.

Me pavarësinë vie detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë dhe do t'i përmbahemi parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit, akteve tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhëniet

ndërmjet shteteve. Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtarë ashtu siç janë paraparë në Aneksin VIII të Planit të Ahtisaarit, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të të gjithë fqinjve tanë. Kosova, po ashtu, do të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jokonsistente me qëllimet e Kombeve të Bashkuara. Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktatave dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Europës Juglindore. Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të lejonte Europën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit. Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për të avansuar të ardhmen tonë të përbashkët europiane.

Ne shprehim, në veçanti, dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike, tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë më tej në të ardhmen e afërt. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'i kontribuar marrëdhënieve të fqinjësisë dhe bashkëpunimit me Republikën e Serbisë duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.

Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitatat e përmblajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.

## SFIDA E SHTETFORMIMIT

(Vijon nga faqja 1)

apo dhe mbajtja pezull e çështjes delikate për Demarkacionin me Malin e Zi, janë të lidhura drejtpërdrejtë me Statusin ndërkombëtar të Kosovës. Parasëgjithash, Kosova po përballet me sfidën reale të shtetformimit. Kjo, për faktin se sovraniteti dhe integriteti i përgjithshëm ose substancial i Republikës së Kosovës në kupti-

min e plotë të fjalës, po vazhdojnë të njohin sfida, udhëkryqe, tatëpjetëza dhe turbulencia të shumta, në kontekste dhe relacione të ndryshme shtetërore, nacionale, teritoriale, politike, administrative, juridike, fetare, kulturore dhe shumë të tjera.

Parë nga ky këndvështrim, në Rend të Ditës për lidhshërinë Kosovë mbetet forcimi dhe konsolidimi i institucioneve në përputhje me standardet perëndimore.




Foto e Kuvendit të Kosovës dyke votuar shpalljen e pavarësisë



## SPECIALE

*Kurorëzimi i një rrugëtimi të dhimbshëm lotësh e gjaku për popullsinë shqiptare*

# Rruga e Kosovës drejt Pavarësisë

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, ishte kurorëzimi i një rrugëtimi të dhimbshëm lotësh e gjaku për popullsinë shqiptare atje. Për vite me radhë, deri në qershor të 1999-ës, shqiptarët vuajtën pasojat e spastrimit etnik nga ushtria e Milloshevićit. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së trupave ndërkombëtare në Kosovë, në nëntor 2005 nisi zyrtarisht procesi për statusin përfundimtar.

Prej 13 qershorit të vitit 1999, kur forcat serbe u detyruan të largoheshin nga Kosova, ky vend administrohej nga misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara UNMIK dhe institucionet demokratike të Kosovës: Kuvendi, Presidenti dhe qeveria. Edhe pse Serbia nuk kishte kontroll mbi Kosovën, në rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, disa herë përmendej se Kosova është protektorat i OKB-së, por juridikisht pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë. Më 2 shkurt 2007 i dërguari special për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, dorëzoi propozimin e tij në Prishtinë dhe Beograd, për pavarësinë e kushtëzuar të Kosovës, hap që çoi drejt krijimit të shtetit të pavarur. Pasi u mbajtën disa raunde bisedimesh, Kosova u shpall e pavarur më 17 shkurt 2008.

Zyra Civile Ndërkombëtare mori përsipër mbikëqyrjen e zbatimit të pavarësisë. Pak ditë më vonë, një grup vendesh që njohën pavarësinë e saj themeluan Grupin Drejtues që do të mbikëqyrte shtetin e ri. Plani i Ahtisaarit nuk u zbatua kurrë në veriun e banuar me shumicë serbe, ku nuk nji-

*Sfida më e afërt për shtetin e ri është heqja e vizave, por kryesorja mbetet aspirata për hyrjen në NATO dhe integrimin në BE. Zyrtarisht, deri më sot, Kosovën e kanë njohur 115 shtete*



hen dhe nuk pranohen institucionet e shtetit të Kosovës.

Plani parashikonte krijimin e një komune të re në veriun e Mitrovicës, që nuk është zbatuar deri më tani. Më

9 dhjetor 2008, vendin e UNMIK e zuri misioni evropian për sundimin e ligjit

EULEX.

Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konfirmoi përmes mendimit këshillëdhënës se pavarësia e Kosovës nuk ka shkelur asnjë nen të Ligjit Ndërkombëtar. Nga marsi i vitit 2011, Prishtina dhe Beogradi kanë nisur bisedimet në Bruksel për një seri çështjesh. Këto bisedime teknike u pasuan nga ato në nivel kryeministrash, me mbajtjen e katër raundeve të dialogut mes Thaçit e Daçiç, si dhe një takimi mes presidentëve Jahjaga e Nikoliç.

Përmbyllja e pavarësisë së mbikëqyrur më 10 shtator 2012, ishte një mundësi për shtyrjen më tej të hapave për integrimin e Kosovës. Sfida më e afërt për shtetin e ri është heqja e vizave, por kryesorja mbetet aspirata për hyrjen në NATO dhe integrimin në BE. Zyrtarisht, deri më sot, Kosovën e kanë njohur 115 shtete.

Deri tani 110 entitete sovraane, nga të cilët 115 nga 193 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë njohur formalisht Republikën e Kosovës. Shumica e vendeve të Bashkimit Evropian gjithashtu e kanë njohur Kosovën (23 nga 28); Anëtarët e BE-së vendosin individualisht se a do ta njohin Kosovën. Njëzetekatër (24) anëtarë të NATOs nga njëzetetë (28) gjithsej e kanë njohur Kosovën.

## Kosova, shtet i pavarur njihet zyrtarisht nga 115 shtete

Njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe e sovranitetit të Kosovës do të mbetet prioritet i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Procesi i njohjes së Kosovës ka treguar se shteti i Kosovës është një realitet i pandryshueshëm dhe një faktor i domosdoshëm i paqes dhe i stabilitetit në rajon. Më së miri kjo dëshmohet nga fakti i njohjes formale të Kosovës nga të gjitha vendet fqinje (me përjashtim të Serbisë), shumica dërrmuese e shteteve nga rajoni dhe komunitetit Euroatlantik.

Arritjet e deritanishme janë një meritë e diplomacisë proaktive dhe dinamike të Kosovës, por edhe një meritë e partnerëve tanë ndërkombëtarë që kanë mbështetur procesin e njohjes dhe kanë lobuar në emër të Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme do të mbetet fuqimisht e angazhuar për të lobuar për njohje ndërkombëtare nga ana e shteteve anëtare të OKB-së, me qëllim të forcimit të pozicionit ndërkombëtar të Kosovës dhe për të vendosur marrëdhënie diplomatike me shumicën e shteteve anëtare të OKB-së.

Republika e Kosovës ka siguruar 115 njohje, në këtë mënyrë ka arritur qëllimin për të pasur më shumë se 100 vende që e njohin Kosovën. Përkushtimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme për të përfunduar procesin e njohjeve ndërkombëtare duhet të përqendrohet në një komunikim diplomatik me shtetet e mëdha që nuk e kanë njohur ende Kosovën, si



Harta e Kosovës by Skender Gagica

brenda Evropës po ashtu edhe përtej saj.

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të mbetet fuqishëm e përkushtuar për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë dhe vazhdimin e dialogut që do të synohet të finalizohet me njohjen e ndërsjellë e që do të mundësonte ndërtimin e paqes së qëndrueshme në mes të dyja vendeve dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike e të mira fqinjësore, në frymën evropiane.

Presidenti i Republikës të Shqipërisë, SHT Z. Ilir Meta gjatë vizitës të fundnëntorit të vitit të kaluar në Medvegje, duke folur për mediat serbe dhe shqiptare, ndër të tjera është shprehur se "Shqiptarët në Medvegje, Bujanoc e Preshevë janë gjithmonë në vëmendjen time. Uroj që Beogradi të marrë vendimin e duhur për pavarësinë e Kosovës, në kohën e duhur, në interes të të gjithë rajonit".

## GJENERAL PARLLAKU URON KOSOVARËT NË 10 VJETORIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS

**K**ryetari i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptare, gjenerali 99 vjeçar Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, në 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, të dytën ditë më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, uron nga zemra vellezerit dhe motrat kosovare.

"Dhjetë vite të pavarësisë së Kosovës nuk kanë qenë vite të lehta. Vështirësi të shumta kanë sfiduar udhën e saj drejt projektit të shtetformimit. Por pjekuria e durimi, forca e mençuria, besimi i pashterë te liria, respekti fisnik ndaj tipareve më të vyera kombëtare me të cilat ju të dashur vëllezër dhe motra, nipër dhe mbesa keni përballuar këto sfida do të shkruhen në faqen e krenarisë sonë kombëtare", shpreh gjeneral Parllaku në mesazhin e urimit për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës.

Gjenerali shekullor, i cili para më shumë se shtatë dekadave, në krye të Divizionit të V-të luftoi heroikisht për çlirimin e viseve të ish-Jugosllavisë, duke marrë dhe një plagë



luftë për çlirimin e Kosovës martire nga pushtuesit nazifashistë, në mesazhin e tij shprehet se Kosova shumë shpejt do të bëhet anëtare aktive e organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare.

Ai përshëndet gjithashtu, të gjitha arritjet e deritanishme të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj për ndërtimin e shtetit të pavarur dhe funksional të Kosovës, si dhe kontributin e rëndësishëm të dhënë në funksion të paqes, sigurisë dhe zhvillimit të rajonit.



## HISTORIA

*Njoftimet për armët e Skënderbeut i kemi në dy rrugë: nga burime të shkruara dhe nga vetë armët që kanë arritur deri në ditët tona*

# Si i morën austriakët armët e Skënderbeut

Ato janë të vetmet objekte origjinale të heroit tonë kombëtar, që ruhen deri më sot dhe ato ruhen në Austri në Muzenë e Vjenës.

Historia e tyre lidhet me jehonën e emrit dhe famës së Skënderbeut në Evropë në atë kohë e më pas. Në vitin 1567, djali i dytë i perandorit të Austrisë Ferdinandi rindërtoi kështjellën “Ambrar” në kryeqytetin e Tirolit, Innsbruck dhe u mor me mbledhjen e sendeve artistike me vlerë e të relikeve.

Sekretari i tij Shrenke mbledhi kryesisht armë dhe i ruajti në kështjellën “Ambrar”. Ai u shkroi letër personaliteteve të shquara të kohës dhe trashëgimtarëve të atyre që kishin vdekur, që t’i dërgonin veshje luftarake, armë, mjete lufte, sende artistike dhe piktura e biografi, sepse do t’i ekspozonte në armëtoren e tij në Kështjellën “Ambrar”. Objektet e grumbulluara, Shrenkeja i sistemoi dhe i inventarizoi gjatë viteve 1585, 1593, 1596 dhe në vitin 1601 botoi në latinisht veprën: “Figura krejt të vërteta të



perandorëve august, të mbretërve e shumë të ndriturve arqidukë, prin-

cave gjithashtu të kontëve, baronëve, fisnikëve dhepërshkrime të bëmave

të tyre, armët e të cilëve ndodhen në armëtoren e kështjellës “Ambrar”. Kjo vepër bëri të mundur që të njihet përkatësia e armëve dhe historia e çuarjes së tyre atje. Në vitin 1605, kështjella “Ambrar” u ble nga perandori i Austrisë dhe armët iu lanë atij. Në vitin 1806 reliket u mbartën në Vjenë dhe në vitin 1888 u kaluan në ndërtesën e re të Muzeumit të Vjenës, ku ndodhen edhe sot.

Armët e Skënderbeut i janë dorëzuar Ferdinandit ndërmjet viteve 1588-1593 me anën e Dukës së Urbinjos dhe atij të Areskotit. Në inventarin e vitit 1596 të Shrenker, me numër 71 është shënuar përkrenarja dhe me numër 92 dhe 345 dy shpatat. Në veprën e Shrenken të botuar në vitin 1601, paraqitet dhe një gravurë e Skënderbeut në pozicion në këmbë, duke mbajtur në dorën e djathtë shpatën (nr 345) dhe pranë këmbëve përkrenaren. Armët e vizatuara të gravurës ngjasojnë me ato origjinale të Muzeumit të Vjenës.

## Shpata që Papa Pali II i dhuroi Heroit, natën e Krishtlindjeve të vitit 1466

**Nga Kristo Frashëri\***

...Nga jeta e Skënderbeut brenda në shtëpi kemi fare pak njoftime. Sipas Dh. Frëngut, ai hante shumë pak dhe i mjaftonin pesë orë gjumë. E duronte vapën dhe acarën. Flinte përdhe mbi qilim. Shton se flinte i veshur me armët dhe ato nuk i hiqte nga brezi as kur flinte-sigurisht e ka fjalën për ditën e luftimeve. Duronte çdo lloj vuajtjeje fizike.

Njoftimet për armët e Skënderbeut i kemi në dy rrugë-nga burime të shkruara dhe nga vetë armët që kanë arritur deri në ditët tona.

Në burimet e shkruara flitet vetëm për shpatat. Dh.Frëngu thotë se shpata e Skënderbeut ishte një pallë e harkuar (una scimitarra storta) me tehe shumë të hollë dhe me damaskinë me shumë hijeshi, e cila për cilindo dukej e rëndë, kurse për të ishte e lehtë. Dikur mbante dy shpata, të cilat i vendoste në një mull.

Pastaj ai shton se njëherë pruri nga Italia një mjeshtër të shkëlqyer, i cili bëri tre palla shumë të mira. Njërin prej tyre, e cila mund të priste hekurin ia dërgoi dhuratë sulltanit. Dimë më në fund se në pritjen zyrtare që Papa Pali II i bëri Skënderbeut në natën e Krishtlindjes së vitit 1466, ai i dhuroi Heroit një shpatë dhe një kësulë (una spada ed un capello).

Përkundrazi nga pajimet personale, që kanë arritur deri në ditët tona, ne kemi katër objekte-dy shpata, një përkrenare dhe një libër uratash. Përkrenarja dhe dy shpatat tani ndodhen në Muzeun e Historisë së Artit në Vjenë, kurse Libri i Uratave, i cili sikurse u tha, ia dhuroi heroit familja Di Capua e Napolit ndodhet në fondet e Shtëpisë Botuese “Shelley House” në Çelsi (Chelsea), Londër.

Përkrenarja dhe shpatat kanë fillimisht një histori të errët. Pas vdekjes së Skënderbeut, ato i morën me vete, e shoqja Donika dhe i biri Gjon, kur mërguan në Itali. Se kush i pati pas vdekjes së tyre nuk dihet. Ato shfaqen në burimet dokumentare në dhjetëvjeçarën e fundit të shekullit XVI.

Në vitin 1590, përkrenarja dhe dy shpatat nuk ndodheshin në një dorë të vetme. Përkrenaren dhe njërin shpatë e kishte në zotërim konti Eolfang i Sturbenbengut. Shpata tjetër ndodhej në Muzeumin e Armëve (siç del nga inventari i hartuar më 30 tetor 1590) të arkidukës Karl i Stirisë, biri i Perandorit të Gjermanisë në Gratz (Austri). Ai që i bashkoi ato ishte biri tjetër i perandorit gjerman (vëllai i Karlit) arkiduka Ferdinand i Tirolit, me porosinë e të cilit, kancelari i tij, J. Shrenke (Jacob Schrenk

von Gotzing), i shtiu ato në dorë (me blerje).

E to ai pasuroi Muzeun që Ferdinand i ngriti në Ambras pranë Tirolit në Austri, të cilin e mbushi me veshje luftarake, mjete lufte, sende artistike dhe piktura të ndryshme të perandorëve, mbretërve, princërve, kontëve dhe figurave të shquara të shekullit XV-XVI. Në inventarin e hartuar në vitin 1595 përkrenarja dhe dy shpatat e heroit renditen ndër objektet e Muzeut të Ambrasit.

Që këtej, një shekull e ca më vonë, në vitin 1806, ato u transferuan në Muzeun Perandorak të Vjenës, por përsëri të veçuara. Përkrenarja dhe shpata me trup të drejtë u vendosën në sallën e quajtur të Maksimilianit (salla XXV, nr.71 dhe 92), kurse shpata tjetër me trup të harkuar (palla), në sallën e quajtur të Karlit V (salla XXVII, nr.345).

Ato u veçuan ngase drejtuesit e Muzeut të Vjenës, nuk ishin plotësisht të bindur nëse palla, e shkëputur nga përkrenarja, i takonte me të vërtetë Skënderbeut. Por, pas Luftës së Dytë Botërore, dyshimet u davaritën. Si rrjedhim në prapun e 500 vjetorit të Heroit, ato u bashkuan në të njëjtën sallë, madje në të njëjtën vitrinë, të po atij institucioni që tani quhet (Muzeu i Historisë së Artit (Kunsthistorisches Museum, Eien).

Përkrenarja e Skënderbeut është punuar me metal të bardhë, pajisur me një rrip (ruban) të larë me ar.

Në majë të saj është vendosur një kokë dhije me brirë, punuar në bronz të larë në ar. Në pjesën e poshtme të saj, ka rreth e rrotull një rrip bakri me një mbishkrim prej gjashtë rrokjesh, të ndarë midis tyre me rozeta: IM\*PE\*RA\*TO\*RE\*BT, që do të thotë: Jhezus Nazarenus\*Principi Emathiae\*Regi Albaniae\*Terrori Osmanorum\*Benedictat Te (Jezui i Nazaretit të bekon ty Skënderbe, Princ i Matit, Mbret i Shqipërisë, Tmerri i Osmanllinjve, Mbret i Epirit). Por rripi prej bakri me këto gjashtë monograme duket se është vënë më vonë në përkrenare nga pasardhësit e Heroit, të cilët kanë menduar se me shtimin e titujve do t’ia rritnin atij vlerën, kurse, siç u tha, ai nuk ka mbajtur asnjë nga këto tituj, por vetëm “Zot i Shqipërisë” (Dominus Albani-ae).

Elementi kryesor që të bis në sy në përkrenare është koka e dhisë, që qëndron në majë të saj. Se çfarë ajo simbolizon mbi përkrenaren e Skënderbeut, është vështirë të shpjegohet me saktësi. Mund të shpjegohet me kultin e dhisë së egër, simbolin e zanave shqiptare, të cilat jetojnë, sipas legjendës, edhe sot në bjeshkët e larta,



përfshirë edhe në atë të Gjellagjoshit, mali që qëndron mbi krye të Qidhnës së Dibrës. Ka shenja që tregojnë së kultit i dhisë së egër është shumë i lashtë. Shkrimtari romak i shekullit të I-II të erës sonë S.Suetom Tanquilli (De Vita Caesarum, L.II, 12, 94) shkruan se perandori romak Augusti, gjatë luftës kundër Batos së ilirëve, kur arriti në Apoloni, preu për nder të fitores së tij, një monedhë argjendi me kokën e dhisë së egër.

Por ka edhe një shpjegim tjetër me ndikim historik. Shefqet Pllana sjell një njoftim të dhënë nga Sami Frashëri në “Kamus-al-alam” në zërin Dhu l’Karnejn se togfjalësi Dh l’Karnejn (pronar i dy brinjëve) ishte apelativ që në kohët e lashta madje edhe në Kuran, i Aleksandrit të Maqedonisë. Nga ana tjetër, L.Malltezi shton pohimin e Plutarkut...Pra, nuk përjashtohet mundësia që motivin e brirëve të dhisë, Skënderbeu ta ketë huazuar, sipas dy historianëve të përmendur ose drejtpërdrejt nga legjenda e Aleksandrit të Maqedonisë, ose, siç duket më bindëse, nga pohimi i Plutarkut, meqenëse në Mesjetë shqiptarët e mbarin veten si pasardhësit e Aleksandrit të Maqedonisë, sidomos të Pirros së Epirit, aq më tepër se për Pirron e Epirit, Skënderbeu ka pohuar shkoqur se shqiptarët janë pasardhësit e tij.

Duket se shpjegimi i dytë ka më tepër të ngjarë të anohet nga e vërteta, mbasi teoria e vazhdimësisë maqedone-shqiptare dhe epirote-shqiptare ishte tepër e rrënjësor jo vetëm në opinionin shqiptar, por edhe në atë evropian. Ky opinion përshkon fund e krye sidomos veprën e Marin Barletit. Mjafton të riprodhojmë një fragment të historisë së tij monumentale, ku ai shkruan: “Njerëzit kur vështronin atë rini luftarake dhe kur shikonin atë lule burrash rreth Skënderbeut, nuk u dukej aq çudi që fuqitë e Muratit ishin thyer prej shqiptarëve. Me të vërtetë ishin kthyer atëhere përsëri shkëlqimi i lashtë i Maqedonisë dhe dukej se kishin ardhur prapë tamam, siç ishin dikur, kohët tanimë të harruara të Aleksandrit dhe të Pirros”.

Me porosi të qeverisë shqiptare të paraluftës, një kopje identike e përkrenares së Skënderbeut, punuar më 1937 nga një mjeshtër i talentuar austriak, ndodhet në Muzeun historik të Tiranës.

Shpata me trup të drejtë, e cila ndodhej sëbashku me përkrenaren në Muzeun e Ambrasit është me dy tehe. Trupin e ka të larë me ar. Është e gjatë 85.5 centimetra, e gjerë 5.7centimetra dhe peshon 1.3kilogram. Ka mëhill lëkure. Sipas Faik Konicës, i cili e vëzhgoi në fillim të shekullit XX në trupin e saj shiheshin ende njolla gjaku. Përkundrazi, shpata tjetër (palla), e cila para se të hynte në Muzeun e Ferdinandit (Ambras) e kishte në zotërim vëllai i tij, Karli (Gratz), ka trup të harkuar. Sëbashku me dorezën është 121 centimetra e gjatë dhe peshon 3.2 kilogram. Palla është e stilit turk të shekullit XV. Trupi i saj është i dekoruar me ornamente (damaskinë-ashu siç shkruan Dhimitër Frëngu). Ka një mbishkrim turqisht, i cili, sipas F.Konicës, nuk është korrekt. Mbishkrimi mban emrin e Skënderbeut: (Libehadur Allah Iskander beg-Kampioni i Perëndisë, Skënderbeu). Sipas Faik Konicës, vetëm trupi i shpatës është i viteve të Skënderbeut. Doreza e larë në argjend dhe mëhilli i veshur me kadife, janë të një kohe të mëvonshme. Të dyja shpatat janë riprodhuar në Vjenë, posaçërisht për muzeun e Tiranës së paraluftës. Sot ndodhen në Muzeun Historik të kryeqytetit.

Ndër dy shpatat, ka mundësi që Skënderbeu në fushën e betejës të mos përdorte atë me trup të drejtë, por pallën me trup të harkuar (siç nënkuptohet nga Dh. Frëngu), për arsye se e para ishte e shkurtër për shtatin e tij të gjatë, kurse me pallën, të cilën e kishte në përdorim ushtria osmane, ai është familjarizuar më tepër se me të parën. Këtyre mund t’u shtohet dhe një arsye tjetër: me të parën luftëtari e kishte më të lehtë ta godiste kundërshtarin horizontalisht, kurse me të dytën kishte përfitim, sidomos kur ishte trupmadh, ta asgjësonte më lehtë armikun me një të rënë të fuqishme vertikalisht. E njëjta gjë mund të thuhet dhe me përkrenaren, e cila nuk duhet të ketë genë komode në fushën e betejës. Përfundimisht, mund të thuhet se si përkrenarja ashtu edhe shpata me trup të drejtë i kanë shërbyer që kjo e dyta të jetë shpata që Papa Pali II i dhuroi Heroit, natën e Krishtlindjeve të vitit 1466.

**\*Marrë nga monografia e autorit për Skënderbeun**



INTERVISTA

*“Përgjegjës për masakrën e Tivarit janë Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe që e kanë ditur planin e jugosllavëve.Sepse kosovarët, nuk kanë dashur që të kalojnë kufirin”*

# Parllaku: Nuk mund të ketë luftë civile kur ke okupatorin brenda

Edhe pse pas tre muajsh mbush 99 vjet jetë, mbart ende freskinë fizike, mprehtësinë e gjykimit dhe energjinë e një burri shteti. Ai i ka kaluar të gjitha fazat në jetën e tij, ngritjet në detyrë e grada, të qenit deputet, por dhe burgun politik ku vuajti për 16 vjet.

Sot burri shekullor rrëfen ‘tradhtinë’ që ushtarakët i bënë Enverit dhe të vërtetën e masakrës e Tivarit. Në një intervistë ekskluzive për “Gazeta Shqiptare”, gjenerali na tregon me krenari historinë dhe luftërat e tij. Gjatë intervistës me zotën Rrahman, dallohet haptazi dashuria dhe lidhja e tij me vendlindjen, me krahinën e Lumës dhe Kosovën.

Parllaku “Liria e Kosovës, ishte ëndrra e jetës sime”, shprehet gjenerali. Qysh në moshë të re ai iu bashkua lëvizjes rinore antifashiste të qytetit të Vlorës, meqë bashkë me të atin dhe të vëllanë për shkaqe ekonomike ishin vendosur në Vlorë. Me 6 janar 1943 caktohet komandant i njësisë guerile të qytetit të Vlorës.

Në lidhje me banimin e tij në Vlorë për një kohë të konsiderueshme dhe ndihmesës së marrë prej vlonjatëve në një periudhë të vështirë në jetën e tij, gjenerali shprehet se; “Pa dyert e zemrat e familjeve vlonjate, ne s’do të mund të bënim asgjë”. Parllaku u largua nga Vlora pasi u emërua si komisar Batalioni në Brigadën e V, e më tej mori pjesë aktive në LANÇ. Bashkë me brigadën e III kaloi në Kosovë, ku pas çlirimit të Pejës me 17 nëntor 1944 emërohet Komandant i Divizionit të V. Me 1946 emërohet drejtor personeli në Ministrinë e Mbrojtjes, ndërsa në vitin 1947 gradohet me gradën “Kolonel”. Në dhjetor 1947 emërohet drejtor i Drejtorisë Politike të Ushtrisë deri në prill 1948, kur u dërgua për studime në Bashkimin Sovjetik, ku i mbaroi studimet e larta ushtarake pranë akademisë së përgjithshme të ushtrisë sovjetike “K.E.Voroshilov”.

Gradën Gjeneral-Major, Parllaku e mori në vitin 1952 dhe atë të “Gjeneral-Leitnantit” në vitin 1964. Rahman Parllaku është dekoruar me 9 urdhra e 3 medalje të luftës si dhe me tre urdhra të shërbimit ushtarak për kontributin e dhënë në ngritjen e gatishmërisë luftarake të ushtrisë. Gjithashtu, për merita të veçanta në luftë, i është dhënë titulli i lartë “Hero i Popullit”.

Në vitin 1974 gjenerali burgoset nga diktatura komuniste me akuzën për pjesëmarrje në të ashtuquajturin “Puç ushtarak për krimin e tradhtisë ndaj atdheut, të sabotimit dhe agjitacionit e propagandës me rrezikshmëri të lartë”. Në bazë të këtyre akuzave u dënua me 25 vjet heqje lirie, nga të cilat 16 vjet e tre muaj i bëri në burgun e Burrelit (16 dhjetor 1974-17 mars 1991), si pjesëtar në të ashtuquajturin grup të Beqir Ballukut. Aktualisht gjeneral Rahman Parllaku është kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës të Popullit Shqiptar.

**Gjeneral Parllaku, ju keni qenë një ndër kuadrot e njohur të qëndresës shqiptare kundër fashizmit gjatë luftës së dytë botërore. Përse u përfshitë në këtë lëvizje?**

Unë kam lindur më 17 prill të vitit 1919 në fshatin Novose të Lumës, rrethi i Kukësit. Shkollën fillore e kam kryer në Shishtavec. Në moshën 12-vjeçare kam filluar punë me babanë dhe vëllanë në profesionin e pastičerit në Cakran të Mallakastrës dhe ne vitin 1936 shkova te punoja në Selenicë të Vlorës. Në prag të pushtimit fashist të 7 prillit 1939, se bashku me vëllanë Selimin, kushërinin Baftjarin si dhe me popullin e Selenicës zbritëm në Vlorë për të kërkuar armë për



të mbrojtur vendin nga pushtimi fashist. Të zhgënjyer e dëshpëruar nga qëndrimi i mbretit dhe qeverisë, që nuk e armatosën e organizuan popullin për luftë kundër fashizmit, u kthyem në Selenicë. Në nëntor 1939, hapëm një pastičeri në qytetin e Vlorës. Aty u lidha me të rinjtë dhe u përfshiva në lëvizjen antifashiste.

**Cilat kanë qenë disa nga funksionet që keni ushtruar gjatë 30 viteve në ushtri?**

E kam filluar si komandat i njësisë guerile të Vlorës në 6 janar 1943 deri në 28 nëntor 1943, kur u transferova me detyrë komisar batalioni. Pas rezultateve të mira në këtë post, u emërova zëvendëskomisar i Brigadës së VIII. Më 8 qershor 1944 u transferova në Brigadën e 3-të Sulmuese dhe së bashku me anëtarët e shtabit që drejtonin këtë njësi përballova me sukses operacionin e qershorit të ushtrisë naziste. Me çlirimin e Kosovës, më 22 nëntor, në qytetin e Pejës marr urdhrin e emërimit komandant i Divizionit të 5-të dhe u gradova kolonel. Në dhjetor të vitit 1947, u caktova në detyrën e drejtorit Politik të Ushtrisë, detyrë të cilën e kreu deri në prill të vitit 1948. Pas kthimit nga studimet, u emërova drejtor i Drejtorisë së Organizim-Mobilizimit në Ministrinë e Mbrojtjes. Në vitin 1952-1954 caktohem në postin e zëvendësministrit të Mbrojtjes e drejtor i Prapavijës së Ushtrisë dhe mora gradën e lartë të gjeneral-majorit. Gjatë viteve 1954-1961 do të shërbeja si zëvendësministër i Mbrojtjes për përgatitjen luftarake të ushtrisë. Nga viti 1961 deri në vitin 1967 kreuva detyrën e komandantit të Forcave Ushtarako-Detare dhe më pas komisar i këtyre forcave dhe mu dha grada “Gjeneral-leitnant”. Në vitet 1969-1970 do të shërbeja si komisar i Forcave Ushtarako-Ajrore dhe një vit më vonë u emërova zëvendësministër për përgatitjen luftarake të ushtrisë.

**Ju jeni dekoruar me shumë tituj për kontributin e dhënë ndaj atdheut. Mund të na përmendni disa prej tyre?**

Për shkak te meritave te lartpërmendura mu dha titulli “Hero i popullit”. Gjithashtu, jam dekoruar me 9 urdhra e tri medalje të luftës dhe 3 urdhra të shërbimit ushtarak për kontributin e dhënë në ngritjen e gatishmërisë luftarake të ushtrisë.

**Në vitin 1974 ju u burgoset nga diktatura komuniste, përse u dënuat?**

Jam dënuar dhe burgosur nga diktatura komuniste për pjesëmarrje në të ashtuquajturin “puç ushtarak”, nën akuzën e “krimit dhe tradhtisë ndaj atd-

heut, sabotimit dhe agjitacionit dhe propagandës me rrezikshmëri të lartë”. Në bazë të këtyre akuzave u dënova me 25 vjet heqje lirie, nga të cilat 16 vjet e tri muaj i vuajta në burg (nga dhjetori i vitit 1974 deri më 17 mars të vitit 1991), si pjesëtar i të ashtuquajturit “grup i Beqir Ballukut”.

**Si ndikoi arrestimi juaj në jetën e të afërmeve tuaj?**

Pas arrestimit tim, drejtimin e familjes e mori im vëlla, Selimi. Menjëherë pasi unë rashë në pranga, djalin e madh të Selimit e liruan nga ushtria, djalin e dytë nga oficer kufiri e çuan punëtor nëntoke në minierën e Mushqetasë ndërsa të tretin Hazbiun e dërguan në Pukë.

**Kur u liruati nga akuzat?**

Duke pasur akuzën e rëndë të “tradhtisë ndaj atdheut”, të ashtuquajturit pjesëtarë të këtij grupi: Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako dhe unë nuk amnistoheshim nga ligjet në fuqi. Në rekursin e bërë nga unë, Gjykata e Kasacionit vendosi, më 20 korrik të vitit 1994, prishjen e vendimit të 5 nëntorit të vitit 1975 të Gjykatës Ushtarake, që i cilësoi fajtorë ushtarakët e lartë, dhe pushimin e akuzave të mësipërme.

**Cilat janë disa nga postet politike që keni mbartur gjër me sot?**

Kam qenë zgjedhur deputet i Kukësit në Kuvendin Popullor për 7 legjislatura rresht, që nga viti 1945 deri në vitin 1973. Gjithashtu, kam qenë kandidat i KQ të PKSH që nga tetori i vitit 1944 deri në Kongresin e Parë. Në kongresin e Katërt rizgjidhem përsëri kandidat i KQ të PPSH dhe në Kongreset e Pestë e të Gjashtë bëhem anëtar i këtij Komiteti. Sot jam kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës të Popullit Shqiptar.

**Ju keni qenë njëri ndër komandantët e divizionit të 5-të që ka marrë pjesë në çlirimin e Kosovës nga pushtuesit gjermanë, ç’ domethënie kishte bashkëngjitja e shqiptarëve bllokut antifashist?**

Bashkëngjitja jonë në atë kohë forcave antifashiste, kontributi që dhamë për çlirimin e Jugosllavisë dhe pengimin e forcave gjermane në tërheqje që po shpejtonin të shkonin në frontin e Normandisë, kundër forcave anglo-amerikane, ka bërë që kufijtë e Shqipërisë dhe të Kosovës të mos ndryshohen, sepse me vetë faktin që i takonim kësaj aleance, Jugosllavisë i pamundësohej ndryshimi i kufijve të Kosovës, e cila siç dihet edhe pse mbeti nën robërinë sllave ajo (Koso-

va) hyri si njësi federale të cilës nuk iu ndryshuan kufijtë e të cilët i ka edhe sot. Pra, them se ishim pjesëtarë aktivë të arritjes së fitores ndaj nazi-fashizmit. Akuzat e atyre që thonë se aradhat partizanë të Shqipërisë ishin në Kosovë për ta shuar kryengritjen e Drenicës në krye me Shaban Polluzhën, nuk qëndrojnë pasi në atë kohë ne luftonim në Bosnjë. Po t’i ngjiteshim boshtit nazi-fashist mendoj se Kosova do të zbrazej nga shqiptarët sikurse u zbraz Zara dhe pjesë tjera të Kroacisë nga italianët. Kështu që shqiptarët mbetën në trojet e tyre shekullore, dhe sot janë faktor kyç në Ballkan.

**Gjeneral Parllaku, si qëndron e vërteta e masakrës së Tivarit?**

Në atë kohë ka pasur lajme sikur divizionet tona kanë vrarë në Kosovë dhe kanë bërë krime, gjë që nuk i përgjigjet të vërtetës. Pas 60 vjetësh u vërtetua që ne nuk kemi vrarë kosovarë, por, kemi luftuar për Kosovën. Në luftimet që drejtova unë në Kosovë, mu vranë në Junik të Pejës, 32 veta dhe u plagosa edhe vetë. Përpos kësaj, zëmë 27 pjesëtarë të divizionit SS Skënderbej rob dhe nuk pushkatuam asnjë. Për fatin tim, në 60-vjetorin për fitoren mbi nazi-fashizmin, në Teatrin e Prishtinës, ku isha i ftuar të flisja për këtë ngjarje, përmenda këtë akuzë dhe thashë: “A do ketë ndonjë të gjallë që ta kujtojë? U ngrit ndonjë nga fundi dhe tha: Jam unë.

**Kush është përgjegjës nga pala shqiptare për masakrën e Tivarit?**

Përgjegjës janë Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe që e kanë ditur këtë gjë. Sepse kosovarët, nuk kanë dashur që të kalojnë kufirin. Në raportet që u ka bërë Zoi Themeli që ishte shef i Degës së Brendshme të Shkodrës, kjo bëhet e qartë. Shefqet Peçi, ishte komandant i korparmatës së III. Pra, këto e kanë ditur. Dhe kjo ka mbetur mister. Ekzekutimi është bërë nga brigada e X malazeze, me urdhrë të Peko Dapçeviç dhe Mila Gjilasë që komandonin korparmatën jugosllave.

**Më herët për ju shkruhej “Rahman Parllaku, gjenerali që tradhtoi Enver Hoxhën”, si e komentoni ju këtë?**

Ne ish-kuadrot e larta ushtarake që u dënuam me dhjetëra vite burgim të rëndë nuk e kemi ndjerë vetën kurrë fajtor për akuzën me të cilën jemi dënuar, dhe asnjëri prej nesh nuk e ka merituar një dënim të kësaj lloji të tillë aq të rëndë. Më saktë do të ishte sikur ato shkrime të mbanin titullin: “E. Hoxha, ai i cili i tradhtoi gjeneralët”.

Siç e dini të gjithë ne kemi qenë luftëtarë të orëve të para, udhëheqës politikë e ushtarakë duke filluar nga çetat e deri në njësitë më të mëdha divizione, korp-armata. Nuk mund të besoj se jam i burgosur, mirëpo E.Hoxha arriti të vendosë në Shqipëri një diktaturë të egër për të cilën gjeti mbështetjen e shumë politikanëve dhe ushtarakëve të asaj kohe, ndaj edhe ne si ushtarakë e mbajmë pjesën e fajit tonë për këtë trend. Ai posedonte mjeshtëri të rralla politike për të bërë makinacione të brendshme në emër të popullit, ndërsa në realitet luftonte kundër interesave të tij. Me të drejtë mund të thuhet se Enver Hoxha humbi besimin tek ne për shkak të mospajimit tonë me konceptin e tij ushtarak (komunist), ai tradhtoi gjeneralët e ushtrisë shqiptare.

**Sipas jush, LANÇ, ishte luftë çlirimtare apo luftë civile?**

E kam shpjeguar dhe më herët që nuk mund të ketë luftë civile kur ke okupatorin brenda. Nuk bëhet lufta mes dy partive të një vendi për pushtet. Lufta u bë kundër okupatorit për çlirimin e vendit dhe në kohë lufte të tillë, luftohen edhe ata që janë në krah të okupatorit. Shembullin e luftës civile e kemi tek fqinjët tonë grekë, ku u bë luftë civile pasi ikën gjermanët nga Greqia. A kanë pasur qëllim pushtetin ata që kanë drejtuar luftën? Patjetër. Sepse ata që luftojnë, duan të jenë edhe në krye të vendit. Por kjo nuk e bënë luftën e popullit, luftë civile.

(Marrë nga “Gazeta Shqiptare”, 9 janar 2018)



## INTERVISTA

Kryetari i OBVL-së, Parllaku - Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, intervistë ekskluzive nga Prishtina, për portalin "Arbresh.info"

# Shqiptarët ndër breza kanë luftuar dhe kanë çliruar Shqipërinë e Kosovën

• **Gjenerali që sfidoi regjimin komunist, i njohur si një prej figurave më emblematike të luftës anti-fashiste nacional-çlirimtare të popujve ka folur edhe rreth bashkimit kombëtar duke treguar se a duhet apo jo të ndodh ky proces**

Rahman Parllaku është gjenerali që sfidoi regjimin komunist i njohur si një prej figurave më emblematike të luftës anti-fashiste nacional-çlirimtare të popujve.

Ai mban dekoratën e lartë "Nderi i Kombit" dhe është vlerësuar ndër vite me shumë tituj.

Parllaku i cili është edhe kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës, tashmë ka mbushur 99 vjet.

Në një intervistë ekskluzive për Arbresh.info ai ka rrëfyer rrugëtimin e tij në Luftën e Dytë Botërore duke qëndruar mes Shqipërisë e Kosovës në përpjekje për shkëputjen e Kosovës nga fashizmi.

Parllaku i cili ka shkruar librin "Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime", ka folur edhe për situatën aktuale në Kosovë dhe Shqipëri. Sipas tij, shqip-



tarët ndër breza kanë luftuar dhe kanë çliruar Shqipërinë e Kosovën, ndërkaq

tani, udhëheqësit nuk po mund t'i integrojnë ato në Bashkimin Evropian.

Ai thotë, se fatkeqësi për shqiptarët është se nuk po mund të merren vesh me njëri-tjetrin. Ish-gjenerali i cili ishte dënuar me vdekje mirëpo kishte shpëtuar me 16 vjet e 3 muaj burgim në kohën e komunizmit, ka folur edhe rreth bashkimit kombëtar duke treguar se a duhet apo jo të ndodh ky proces. Ndiqeni intervistën e plotë dhe rrëfimin e tij interesant për luftërat që janë zhvilluar në trojet shqiptare.

Me poshte keni linkun e intervistes që është publikuar në portalin tone "Arbresh.info"

<http://www.arbresh.info/aktuale/ish-gjenerali-shqiptar-99-vjecar-nuk-po-merremi-vesh-njeri-tjetrin/>

**FLUTURA GASHI-MEHMETI**

Redaktore në portalin "Arbresh.info"  
Adres: Rruga "UÇK", Kompleksi Qafa,  
Kati I, Nr. 1, Prishtinë- KOSOVË

## HOMAZH

## ERNEST JAKOVA - hartuesi i studimeve bashkëkohore ushtarake

Familja, të afërmit, miqtë, bashkëluftëtarët dhe bashkëpunëtorët përcollën për në banesën e fundit, me të gjitha nderimet që meritonte, gjeneral Ernest Jakovën, i cili u nda nga jeta më 26 janar 2018.

Ernest Jakova ka lindur në Shkodër, më 26 janar 1921, megjithëse në të gjitha dokumentet viti i lindjes është 1923. Babai Kola, me profesion marangoz, në vitin 1928 shpërngulet me gjithë familjen nga Shkodra në Tiranë. Në Tiranë ka kryer shkollën fillore (pesë vjeçare) dhe katër vitet e para të gjimnazit (semi-maturën).

Në vitin 1937 nis studimet në Shkollën Ushtarake të Milanos.

Atje u shqua në grupin e atletëve të shkollës, ku merrte pjesë në garat që zhvilloheshin çdo dy vjet ndërmjet tre shkollave ushtarake të Italisë.

Më pas Ernest Jakova studjoi në Akademinë Ushtarake të Aviacionit në Kazerta. Në pushimet e vitit të dytë të akademisë, ndërsa ishin në Shqipëri, më 20 Korrik të vitit 1942, bashkë me shokun e shkollës Mahmut Agolli, doli ilegal.

Katër ditë pasi kishin dalë në ilegalitet, bashkë me Mahmut Agollin marrin pjesë në grupin e Mihal Durit në aksionin e rëndësishëm të ndërprerjes së ndërlidhjes telefonike në të gjithë Shqipërinë.

I kalitur në aksionet e grupeve të ilegalëve, djaloshi që kishte qënë student në Akademinë e Aviacionit dhe kishte braktisur studimet shumë shpejt do të radhitej si partizan në Çetën e Pezës. Gjatë gjithë kohës që ka qëndruar në

Çetën e Pezës, si Zv/Komandant i Batalionit III, me Komandant Kajo Karafilin deri në tetor 1943, kur u formua Brigada e III Sulmuese në Arbanë, ka marrë pjesë në të gjitha aksionet e saj.

Në fund të vitit 1943 transferohet në Brigadën e II-të Sulmuese, me detyrën Zv/Komandant i Batalionit të Dytë me Komandant Nasi Vithkuqi, që ishte i moshuar dhe Komisar Kalo Plaku.

Gjatë gjithë luftimeve të kësaj brigade mbante nën sqetull një xhakete (gjysëm pallto) gjermane të marrë po aty, me të cilën kaloi gjithë dimrin 1943-1944.

Mbas Luftës Ernest Jakova ka kryer dy Akademi Ushtarake në ish BS. Në vitet 1945-1947 ka kryer dhe është diplomuar në Akademinë Ushtarake "FRUNZE". Mbas dhjetë vjetësh, në vitet 1957-1959, ka kryer dhe është diplomuar në Akademinë Ushtarake "VOROSHILLOV", që konsiderohej Akademia më e lartë në botë për kohën.

Grada Gjeneral-major iu dha në vitin 1963, në moshën 40-vjeçare, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm Petrit Dume, nga Kryeministri Mehmet Shehu me miratimin e Enver Hoxhës. Gradën Gjeneral-major e morë njëkohsisht me të edhe oficerët Abaz Fejzo e Mendu Backa.

Gjeneral Ernest Jakova kreu me devotshmëri e përkushtim detyra të rëndësishme në ushtri, si komandant i Divizionit të Tiranës, Zëvendës Drejtor i Drejtorisë Operative pranë Shtabit të Përgjithshëm të FA, zëvendës drejtori i Institutit të Studimeve Ushtarake, etj.

Kudo dhe kurdoherë u dallua për për-



gatitjen e lartë, kompetencën e profesionalizmin, por edhe për kurajon e guximin në kapërcimin e vështirësive.

Por, me gjithë kontributin madhor, edhe ai u listua nga diktatori Hoxha për t'u goditur si pjesëmarrës në të ashtuquajturin "grup armiqsor në Ushtri". Pasi u cilësua nga diktatori Hoxha si "kalemxhi", erdhën dhe masat represive ndaj tij. Ernest Jakova u përjashtua nga Partia dhe u lirua nga ushtria, masa këto që ndikuan në persekutimin e tij të mëvonshëm, duke u lënë në "hiqe" dhe duke u survejuar në çdo hap që hidhte nga i ashtuquajturi Sigurim i Shtetit.

Si i tillë ai e priti me gëzim dhe optimizëm ardhjen e demokracisë e të pluralizmit në vendin tonë. Që në fillim

mbështeti krijimin e OBVL-së dhe për afro dhjetë vjet kreu me devotshmëri detyrat e ngarkuara për konsolidimin e kësaj organizate.

Ernest Jakova është një vlerë në historinë e ushtarakëve shqiptarë. Ai ishte studiuesi ushtarak sistematik dhe i palodhur dhe me kërkesa të larta shken-core, hartuesi i planeve të mëdha operative-strategjike dhe hartues i studimeve bashkëkohore ushtarake.

Në librin e tij "Prapaskenat kobzeza të Enver Hoxhës", botim i vitit 2008, gjeneral major Ernest Jakova i bën një skaner gjithë veprimtarisë kriminale të diktatorit Enver Hoxha si gjatë viteve të luftës dhe më pas, me instalimin prej tij të një prej diktaturave më të ashpra.



## KUVENDI

*U mbajt Kuvendi zgjedhor i OVLANÇ të Kosovës-dega në Prizren*

# ANGAZHIM KONKRET NË MBROJTJE TË VLERAVE TË LANÇ



**Nga Bashkim Hisari**

Në praninë e delegatëve, familjarëve, pjesëmarrësve në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare (LANÇ), anëtarëve të Kryesisë së organizatës së veteranëve të LANÇ të Kosovës(OVLANÇ) dhe të qytetit të Gjakovës, në Prizren u mbajt Kuvendi zgjedhor i OVLANÇ të Kosovës-dega në Prizren.

Me këtë rast u analizua puna e deritashme dhe u miratua programi i punës për periudhën e ardhshme, si dhe u fol për një numër aktivitete të cilat duhet të përmirësojnë kushtet e pavolitëshme të punës së kësaj dege.

Në Kuvend u nderuan me respekt të gjithë ata që ishin pjesë e popujve që u renditën në krahë të fituesëve të Luftës së Dytë Botërore. U theksua se në luftën dhe rezistencën kundër pushtuesit nazifashistë, vrasjet, masakrimet, burgosjet e as internimet nuk arritën dot t'i ndalin shpirtin liridashës të qytetarëve të Prizrenit. Për çlirimin dhe lirinë e vendit dhanë jetën 135 prizrenas, 6 prej tyre u shpallën hero i popullit kurse 57 ishin bartës të përkujtimores partizane të vitit 1941.

**• Për çlirimin dhe lirinë e vendit dhanë jetën 135 prizrenas, 6 prej tyre u shpallën hero i popullit kurse 57 ishin bartës të përkujtimores partizane të vitit 1941**

Pjesëmarrësit shprehën brengosje pse herë pas here në disa mjedise po hidhet "baltë" ndaj LANÇ, kur edhe aleatët tanë e vlersojnë lartë luftën heroike, për liri, barazi e organizuar nga pupulli dhe e cila mbetet si luftë e madhe popullore. Ata parashtruan nevojën e angazhimit më intensiv që lidhet me vlerat dhe mbështjen e LANÇ dhe për të mbrojtur e çuar përpara vlerat e saj.

Në programin e punës për periudhën e ardhshme parashihet që antarët e degës së OVLANÇ të Kosovës-dega në Prizren të angazhohen në vlersimin e drejtë të LANÇ dhe të kontribuojnë ndryshimeve demokratike që po bëhen në Kosovë.

Programi parashihet edhe këto aktivitete:

Plotësimin e kushteve ekzistenciale për familjet e dëshmoreve të LANÇ dhe të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), zgjidhjen e drejtë të çështjes së punësimit të familjarëve të tyre pa dallime partiake e politike;

Angazhimin e antarëve për përcaktimin e të drejtave dhe beneficioneve të veteranëve të LANÇ të cilët me sakrificën dhe kontributin e tyre të çmuar ishin faktor i rëndësishëm për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë së popullit të Kosovës;

Realizimin e kërkesave nga oganet dhe institucionet komunale dhe ato qendrore që të kushtojnë kujdes dhe të kontribuojnë në pengimin e rrënimëve dhe dëmtimeve të shtatoreve, pllakave përkujtimore dhe varrezave të veteranëve të LANÇ;


Disa rrugë, shkolla e institucione publike në komunën e Prizrenit të emërtohen edhe me emra të dëshmorëve dhe heronjëve të popullit;

dhe Organizimin e tubimeve përkujtimore për veteranët e LANÇ, synimi i cilëve ka qenë çlirimi, lufta për barazi dhe pavarësia e Kosovës.

Kuvendi zgjodhi Vjosa Currin për kryetare, Murat Qerretin për nënkryetar dhe Vera Muratin për sekretare të OVLNÇ të Kosovës-dega në Prizren.

**HOMAZH**

**LAMTUMIRË  
VANGJEL KOKERI**



Familjarët, të afërmit dhe miqtë e shumë, më 22 janar 2018 i dhanë lamtumirën e fundit veteranit të LANÇ, Vangjel Kokeri.

Dhimbja për ndarjen nga jeta të njeriut më të afërm të familjes, njëkohësisht mikut, bashkëluftëtarit e bashkëpunëtorit tonë më të ngushtë na ka pllakosur të gjithëve. Me ndarjen e tij nga jeta, Familja humbi bashkëshortin, babain e njeriun më të afërm, ne humbëm mikun më të ngushtë, me të cilin së bashku fituam disa beteja e sfida të përbashkëta.

Vangjel Stefan Kokeri ishte një nga veprimtarët shembullorë të OBVL-së.

ka lindur më 1928 në Leskovik. Ka marrë pjesë në luftën Nacionalçlirimtare nga qershori i vitit 1944. Ndonëse fare i ri në moshë u shqua për guxim e trimëri, cilësi këto të treguara fillimisht në Batalionin "Dajti", dhe më pas me formimin e Brigadës së 23-të S në shtator të atij viti, si partizan i saj.

Ndoqi me përkushtin aktivitetin e kësaj brigade deri në shkurt të vitit 1946, kur lirohet me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, si i ri në moshë (nën 18 vjeç).

Ka shërbyer si nënoficer armatimi i Batalionit të III-të të Brigadës së 3-të S me gradën "reshter".

Pas çlirimit, Vangjel Kokeri kreu me devotshmëri, përkushtim e profesionalizëm detyra e funksione të rëndësishme.

Për pesë vjet (1953-1958) punoi në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ndërsa pesë vitet në vijim (1958-1963) në Seksionin e Fdinancës të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës.

Si një ndër financierët më të zotë në shkallë vendi, Vangjeli do të shquhej edhe në NZSH ku punoi deri sa doli në pension.

Është dekoruar me Medaljet e Çlirimit dhe të Trimërisë.

Pas vitit '90 Vangjel Kokeri mbështeti proceset demokratike, ku një kontribut të çmuar ka dhënë në strukturimin e OBVL. Si anëtar i Kryesisë së saj njihet për përkushtimin maksimal dhe angazhimin konkret në përmbytjen e detyrave.

Duke ju shprehur ngushëllime Familjes dhe të afërmeve, ju garantojmë se Vangjeli do të mbetet përjetë në kujtesën tonë si një nga miqtë, bashkëluftëtarët e bashkëpunëtorët më të ngushtë, me vrytytet më të çmuara njerëzore që mishëronte e transmetonte në Familje e shoqëri.

Lamtumirë miku ynë i shtrenjtë Vangjel Kokeri.

Të qoftë i lehtë dheu i tokës mëmë!

**Myfit GUXHOLLI  
Nënkryetar i OBVL**

## OBVL uron drejtuesit e rinj të OVLANÇ-së të Kosovës, dega Prizren

Kryesia e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar (OBVL) uron OVLANÇ-së të Kosovës, dega Prizren.

Në mesazhin e urimit për drejtuesit e rinj: Vjosa Curri, kryetare e degës OVLANÇ-së në Prizren: Murat Qerreti, nënkryetar dhe Vera Murati, sekretare, kryetari i OBVL, gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, vlerëson angazhimin dhe përkushtimin e tyre dhe shpreh bindjen për një bashkëpunim të frytshëm mes dy organizatave.



## LIBRI

Në 80 vjetorin e lindjes, pak fjalë për librin e tij “ABC - ja e Boksit”

# RAMIZ REKA – MJESHTRI DHE TEORICIENI I BOKSIT

**SHPENDI TOPOLLAJ**

Në aradhen e nderuar të sportistëve dhe trajnerëve tanë në përgjithësi dhe atij të boksit në veçanti, mjeshtri Ramiz Reka zë një vend të veçantë. Dhe kjo jo thjesht për vlerat e tij të spikatura si boksier mjaft karizmatik, si njeri korrekt dhe mjaft të dashur me shokët dhe miqtë apo si një nga restauratorët e palodhur të këtij sporti te ne. Ai shquhet në radhë të parë për kontributet e vyera në propagandimin, përhapjen dhe vënien mbi baza shkencore të këtij sporti me anë botimesh me profesionalizëm të lartë. Ai nuk u drejtohet vetëm boksierëve, por në radhë të parë trajnierëve e pedagogëve, duke e kuptuar rolin e tyre ashtu sikurse bënte kampioni absolut i botës Majk Tajson, që në personin e Kas D`Amatos shihte edukatorin, prindin dhe trajnierin e përkushtuar i

cili jo vetëm e çoi në piedestalin e këtij sporti, por edhe e drejtoi si njeri në rrugë të drejtë, nga ajo që gabimisht, dhe për shkak të rrethanave ai kishte nisur. Kam pasur fatin të njihem qysh pa u botuar dhe të shkruaj rreth dy librave të fundit të Ramizit. Në librin e tij të mëparshëm “Boksi”, duke iu referuar mallkimit të gjatë që ju bë këtij sporti, pata përmendur thënien e Joromoto Tashit se “Një pasion i ndërprerë mund t’i lerë vendin një pasioni akoma më të fortë.” Dhe ja, ku falë këtij pasioni të admirueshëm, ky autor na sjell librin tjetër me titull “ABC - ja e Boksit”, nga i cili po sjell komentimin modest:

I përfshirë në programin e Lojrave të 23 - ta Olimpikë, sporti i boksit ose siç quhej atëherë, luftimi me grusht, u hoq pas ndërprerjes së këtyre lojrave në vitin 3104 të e.s. nga Perandori Teodos. Të njëjtën gjë bëri me të edhe Teo-



dosi ynë, Enver Hoxha i cili e anatemoi këtë sport të bukur e burror që me përkushtimin e sportistëve dhe trajnierëve të talentuar dhe të përkushtuar, kishte krijuar jo vetëm një profil aq të dashur për këdo, por dhe traditën simpatike të shkollës shqiptare të boksit. U detyruam për një kohë të gjatë që ta ndiqnim atë fshehurazi dhe plot emocione nëpër stacionet e ndaluar televizive, gjë që na dha jo vetëm kënaqësinë por edhe mundësinë që ta mbanim të ndezur si entuziazmin e tifozerisë ashtu edhe dëshirën për ta parë atë të gjallë në ringjet tona. Por rivedosja e dinjitetit të këtij sporti, pas fitores së demokracisë, natyrisht që nuk ishte dhe aq e lehtë. Kjo ndërmarrje nuk mund të realizohej as mbi dëshirë e as mbi imazhe të së shkuarës. Ajo

kërkonte, mendësi të reja, tërheqjen e vëmendjes së shtetarëve, përpjekje të pareshtura, gjetje fondesh, krijimin e mjediseve dhe bazës së nevojshme materiale dhe organizim e planifikim serioz për veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. Për sportin shqiptar ishte fat që ende nuk ishte shuar flaka e dëshirës për ta rimëkëmbur atë tek ish sportistë dhe kuadro të nderuar, ku një rol i veçantë i takon njeriut të apasionuar dhe këmbëngulës, mjeshtrit të sportit, teorikut dhe arbitrit të njohur Ramiz Reka i cili me punën e tij të palodhur është shndërruar në një institucion më vete. Me artikujt e tij të shumtë e plot kulturë bashkëkohore dhe sidomos me librat që ka shkruar, siç e tregon edhe ky që po u jepet në dorë, Ramizi pa frikë mund të shpallet njëzëri dhe pa pasur nevojë për juri, Kampion i Shqipërisë për rivendosjen e prestigjit të sportit të boksit në vendin e merituar. Gjithashtu, ai do të mbahet mend gjatë si sportisti intelektual që e përshkroi “luftën me grushta” si art, si një lloj arti ku evidentohen akoma më shumë vlerat dhe virtytet njerëzore dhe ku ruajtja e miqësisë i zotëron pasionet, ambicjet dhe egoizmin që janë bashkudhëtare të çdo sporti. Vetë jeta e nderhme e Ramiz Rekës është shembulli më elokuent i këtij pohimi; miqtë e tij të shumtë do t’i gjeshe anë e kënd Atdheut. Ata do jenë pranë tij sa herë ai gjen arsyen për t’i mbledhur, qoftë edhe për të kaluar së bashku disa çaste të gëzuara, ku evokohen aq e aq kujtime të pashlyera për shokët dhe sukseset e tyre ndër vite. Për ata shokë që rrojnë apo kanë ndërruar jetë dhe që e zhvillonin këtë sport brenda kornizave të përvojës dhe njerzillëkut dhe që sot që kohët kanë ndryshuar, Ramizi kërkon të zhvillohet sipas kritereve shkencore.

Në 80 vjetët e jetës së tij të pastër dhe plot përkushtim, kushdo që e njohu është bindur se Ramiz Reka ka mbetur si ai Akati i “Eneidës”, shok e mik besnik, çka do të thotë se ai e ka pasur të ngulitur në mendje e në zemër, atë thënien e kontit Leon Tolstoi se “Dashuria reciproke ndërmjet njerëzve është ligji themelor i jetës njerëzore.” Ndaj, në emër të këtij ligji themelor moral, i uroj që edhe në të ardhmen të vazhdojë të ndjekë rrugën e ndritur të Rafael Dëshnicës, Rexhep Ramës dhe Ali Kastratit me shokë dhe njëkohësisht i kujtoj se shoqëria ende pret prej tij të tjera libra, se është ashtu siç thosh Zhan Pol Satri si “Të shkruash do të thotë të japësh.”

## RESUL BEDO, “biografi i 28 mijë dëshmorëve”

**Halil RAMA**

Një vit më parë, më 10 janar 2017 ndërroi jetë në moshën 101-vjeçare shkrimtari dhe publicisti i njohur Resul Bedo.



Resul Bedo...

Resul Bedo është një nga intelektualët dhe autorët që ja kushtoi jetën e tij krijuese Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Ai është autori i përmbledhjes për gjithë dëshmorët e LANÇ, “Yje të Pashuar”, një nga botimet më serioze për 28 mijë dëshmorët e luftës.

Ky botim, por edhe dhjetëra libra dhe mijëra artikuj të tjerë letrarë dhe studimorë bënë që Bedo të njihet si “biografi i 28 mijë dëshmorëve”. Krijimtaria e tij numëron rreth 120 vepra, mes të cilëve; romane, novela, vëllime me tregime.

Resul Bedo nuk është vetëm biografi të dëshmorëve, por edhe një prej pjesëmarrësve aktiv në Luftën Nacional Çlirimtare.

Ai lindi në vitin 11026 në fshatin Fushëbardhë të Gjirokastrës. Në moshën 15-vjeçare, ishte nga të parët që u rreshtua në çetën “Çerçiz Topulli”, më pas në batalionin “Asim Zeneli” dhe më vonë në Brigadën e 6 Sulmuese. Gjatë luftës mori pjesë dhe në betejat në Jugosllavi. Ndërsa pas çlirimit të vendit do të ishte nga ushtarakët që morën pjesë në përballjet me Greqinë gjatë provokacioneve në kufi, më vitin 11048.

Krijimtarinë e tij e nisi që në moshë të re në botimet e shtabeve të ushtrisë, për tu bërë më pas një nga autorët më të spikatur të historisë së luftës dhe heronjve të saj.

Ceremonia e varrimit të shkrimtarit dhe veteranit Resul Bedo u zhvillua më 10 janar 2017 në varrezat e Tufinës në Tiranë.

*Disa nga librat e Resul Bedos*

“Yje të pashuar”

“Çlirimi i Shkodrës”

“Gjurmë të ndezura”

“100 episode partizane”

“Në zemër të maleve”

“Shtegtim i largët”

“Divizioni vi “sulmues” në fletët e një ditari”



## PROFIL

## Kur Dedë Qafën e thirri “Zani i të parëve të tij”

## Xhemal Meçi

Dedë Qafa, i ndarë para disa ditësh nga jeta, ishte dhe mbetet shembull frymëzimi për veteranët dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të OBVL-së. Ai i përkiste një familjeje të shquar veterane e LANÇ-it.

I ati i tij, Nikollë Ndrecë Qafa mirëpriti partizanët e Brigadës XXII-S me komandant Sali Verdhën, i cili në Muzeun Historik, më 29 Nëntor 2003, tregoi se “ishte Nikollë Ndrecë Qafa që më priti dhe ushquu me mish dhjetra partizanë të unshëm, si dhe u dhuroi veshmbathje partizanëve të mbetur keq për rroba opinga e këpucë”.

## QAJAJT, FAMILJE DËSHMORI TË ATDHEUT

Qafajt janë familje e njohur dëshmori të atdheut. Çup Prengë Qafa u vra me ushtrinë pushtuese serbe, më 1912. Sapo u kthye në Vendlindje, u përlesh me forcat pushtuese serbe, duke rënë në dhjetor 1912 Dëshmor i Atdheut, shpallur me Vendim Nr.666, dt. 27.06.2013.

Por Familja Qafa, jaqnë edhe një prej familjeve më të persekutuar të rrethit të Pukës nga rregjimi Komunist, sepse Qafajt nuk u pajtuan me vendosjen e terrorit komunist dhe reformat antiekonomike. Ndaj bijve tyë saj u kryen arrestimet pa fakte e të shpifura. Kështu arrestohet Gjokë Qafa për djegien e Sharrës së Kryeziut në bashkëpunim, akuzë krejtësisht e sajuar. Prandaj Pjetër Çup Qafa u arratis në Jugosllavi dhe në vazhdim në SHBA. Qafajt filluan të burgoseshin si të afërt të Pjetrit dhe se gjoja mbajtkan lidhje me te” këtë Agjent të CIAS amerikane.” Pal Qafa, gjoja si axhent i tij, u burgos e u torturua barbarisht, pastaj u pushkatua dhe u varros diku në Tër-bun. Edhe Deda ka vuajtur, sepse përndiqej, se e merrnin për Palin, të cilit i ngjante shumë nga pamja. Ndërsa u burgosën edhe të tjerë Qafaj: Ndue Qafa, Frrok Qafa, Mark Qafa, Prengë Qafa, Pashk Qafa, Victor Qafa.

Po kështu edhe Nikollë Ndrecë Qafa u burgos duke u mbajt 4 vjet në burg(1956 – ’59). Nikolla edhe pse e mirëpriti Brigadën XXII-S me një bujari të paparë aso kohe, me një pritje si askush deri atëhere në Veri, Këto nuk mund të harrohen e të minimizohen, siç janë përpjek partiakë e sigurimsa, derisa këto fakte i mori në dorë dhe i mbrojti kryesia e Organizatës së veteranëve të rrethit me kryetar Pashk Shytin duke kërkuar që Nikollë Qafa të shpallej “Qytetar Nderi i Bashkisë Fushë-Arës” siç u arrit me Vend. Nr. 32, dt. 30.06. 2003, Duke rënë kështu akuza fallco, në bazë të cilës qe dënuar 4 vjet burg.. Edhe pse Nikolla kishte lënë në shtëpi gruan, Prenda Memë Qafa me pesë fëmijët: Prengën, Bibën, Zefin, Dedën dhe Marën, Prenda si një grua burrëreshë, i rriti ashtu si donte Nikolla: me edukatën prindërore: me dashurinë për punën e humanizmin




dhe këmbënguljen në përballimin e vështirësive të jetës.

Këtë edukatë shpalosi Deda, i cili sapo përfundoi shkollën e detyruar 7-vjeçare, në moshën 15-vjeçare, hyri në punë në ndërmarrjen e përpunim drurit, sadoqë aty puna ishte e rëndë për moshën e Ti. Mbas përpjekjesh të gjata i bindi eprorët drejtuesit e ndërmarrjes që për nevoja të ndërmarrjes të kalonte elektrikist, si të kryente një kurs përgatitor. Mbas kursit arriti të kalonte si elektrikist në ndërmarrjen e ndërtimit, ku ishte më i pavarur dhe mundësi vetëkualifikimi edhe pse i duhej të shkonte edhe në sektorë në thellësi të maleve, ku punonte me kujdes e saktësi, duke fituar respektin e të gjithëve. Njëkohësisht tregohet sportist i talentuar. Prandaj, ndërsa punonte elektrikist mendjen e kishte te shkolla sportive. Kështu me ndihmën e disa shokëve arriti të regjistrohej dhe të vazhdonte ilegalisht pashkëputje nga puna shkollën e Mesme Sportive Durrës. Nga dashuria për arsimim të plotë, pashkëputje nga puna, i hyri edhe Institutit të Lartë të Kulturës Fizike, “Vojo Kushi” Tiranë, ku më 1994 u diplomua. Diplomë, të cilën nuk mundi ta praktikonte; por prapë ishte krenar, se ai me vullnetin e tij mundi më në fund të sfidonte persekutimin komunist, për mosdhënien të “së drejtës” për arsimimin e të rinjëve nga familjet e persekutuar. Vetëm edhe për këtë shembull do të duhej të respektohej dhe të nderohej Dedë Qafa. Por Deda ka dhe ndihmesën e dhënë për proceset demokratike dhe rikthimin në jetën private të fëmijëve të Ti. Ideal i Ti ishte me shkue te origjina e të parëve dhe me qëndrue tolerant me komunitete dhe përbërje politike të ndryshme. Prandaj, bashkëqytetarët e Ti do ta kujtojnë pa reshtur Dedën, njeriun që e kishin gjithnjë në krah: në të mirë e në të keq.

nuk mund t’i harronte këto bujari, prandaj e nderoi me “MIRËNJOHJE TË KOMUNËS GJAKOVË”, kurse Presidenti i Republikës Prof. dr. Bamir Topi me urdhërin e Lartë “MJESHTËR I MADH” me Dekretin Nr.7147, dt.02.11.2011 me motivacionin: “PËR KONTRIBUT SHUMËVJEÇAR NË RRETHIN E PUKËS, SI PUNONJËS I PËRKUSHTUAR DHE DREJTUES I AFTË, PËR ARRITJET SI BIZNESMEN I SUKSESSHËM, I CILI SHQUAN PËR HUMANIZMIN QË TREGON NDAJ NJERËZVE NË NEVOJË”. Tani kishte vetëm një marak të botonte një libër për traditat e familjes, të cilin e arriti me titullin “ZANI I TË PARËVE TË MI” me ndihmën e studiuesit të mirënjohur Ndue Dedaj.

Gjithashtu, kur Deda ndërroi jetë në mesin e dimrit, 16 dhjetor 2017, ditën e homazheve dhe të përcjelljes në varreza, 18 dhjetor, morën pjesë qindra vetë nga komuniteti i Fushë-Arësit, shokë e miq të ndjerit Dedë: nga Tirana, Shkodra, Lezha dhe Kosova. Ndërsa Gjeneral Rrahman Parllaku, “Hero i Popullit” dhe “NDERI I KOMBIT”, Kryetar i OBVL-ës, ndjeu dhëmbje të thellë për këtë figurë të nderuar, familje Veterani të Luftës e Familje Dëshmori, i shprehu nëpërmes Astrit Meçit, familje VETERANI nga Puka, ngushëllimet e Tia të përzemërta Familjes së DEDËS dhe porositi një kurorë mortore me lule për në varrezat familjare. Bashkëshortja e të ndjerit Dedë, Rregjina, duke përshëndetur pjesëmarrësit e shumtë në këtë homazh mortor, dhe nderin që i bëhej nga Gjenerali, ikona e LANZFNÇLR, u shpreh: “Ky nderim që i bëhet sot të ndjerit Dedë, të njeriut tonë të shtrenjtë, është një nderim edhe për familjen e Ti, djemtë: Shkelzenin, Floridi dhe vajzën Elsen, nipa e mbesa, miq e shokë, të pikëlluar për ndarjen për jetë prej të nderuarit Dedë Qafa. Dhe jam e bindur se edhe ne do ta ruajmë kujtimin e të ndjerit e të paharruarit Dedë Qafës me atë respekt, mirëpritje, bujari, e mirëkuptim që kishte Ai në komunitet, miq e shokë.”

## \*Studiues, “Mjeshtër i Madh”



## SHPIRTI HUMAN I DEDË QAFËS

Këtë shpirt human trashëgoi edhe Deda me të vëllezërit. Humanizmi i tij shkëlqeu edhe një herë nga 3 prilli – 28 qershor 1999 gjatë gjenocidit serb në Kosovë, kur para hotelit të tij u rreshtuan afro 700 vetë: burra e gra djem e vajza të shoqëruar e të pashoqëruar me prind apo të afërm, të cilët u sistemuan në hotelin e Dedës në siguri të plotë. U qëndronte afër për çdo nevojë bashkëshortja e Dedës Rregjina me vajzën, Elsen dhe djemtë: Shkelzenin e Floridin. Ushqimi u gatuhej në kuzhinën e hotelit. Të gjitha me shpenzimet e Dedës e familjes së Ti. Komuna e Gjakovës



## LIBRI

*Burri fisnik Mark Qerimi dhe vëllazëria delia e blinishtit të Pukës*

# LIBËR QË I FLET TË KALUARËS

**Dr.Nikollë LOKA**

Kur flasim për një familje, por edhe për një individ të njohur, mendësia popullore i referohet shpisë, një objekt jetëgjatë plot jetë, që përfaqëson njerëzit, pret e përcjell, nxjerr tymin që ngjitet lart e duket që nga larg. E shohin miqtë, udhëtarët, të njohur dhe të panjohur.

Të qenit shtëpi me emër është titull nderi që nuk jepet, por ftohet me meritë gjatë disa brezave.

Në librin e Ismet Balajt dallohen qartë trajtimi historik që i bëhet krahinës së Pukës, edhe pse shkruan libër për një familje të vetme. Ai ka ditur të përcjellë vlerat e kësaj familje përmes përshkrimit të njerëzve të saj dhe të ngjarjeve që ato kanë jetuar.

Historia u ruajt përmes rrëfimeve gojore dhe emrave të vendeve, një lidhje e përvetshme midis njerëzve dhe tokës. Siç na e thotë Prof. Ismeti, “Mbi fushën e Blinishtit ndodhet kalaja e Lekës që është ndërtuar për të kontrolluar rrugën e madhe Shkodër-Prizren, në një segment të vështirë të saj, por ndërkohë kryente dhe funksione mbrojtëse për banorët. Dukuria e vendosjes së popullsisë në vende të larta dhe më të mbrojtura takohet gjatë periudhës së pushimit sillav edhe në vendbanime të tjera dhe kalatë në këtë periudhë shërbenin për mbrojtjen e popullsisë gjatë luftës. Në Blinisht ndodhen Sarajet e Lekës, por edhe guri i filxhanave, ku Lekë Dukagjini “i priste me kafe udhëtarët”. Fisnikëria shqiptare e shekullit XI-XV u formua si rezultat i bashkëveprimit të aristokracisë së vjetër arbëre me krerët e fiseve në trevat malore. Në atë kohë, princi feudal kishte në shërbim të vet familje të fuqishme me numër të madh meshkujsh, të cilët në shkëmbim të angazhimit në luftë fitonin prona në toka bujqësore, zabele, livadhe etj. Krerët që drejtonin familje, vëllazëri dhe fise të mëdha hynin në aristokracinë vendëse dhe gëzonin disa privilegje të njohura. Një marrëdhënie të tillë ndërtoi Lekë Dukagjini me disa familje në Pukë, ndër të cilat edhe me familjen e madhe të Dakës. Sipas gojëdhënës, “Shpia e Dakës kishte mbi 100 frymë, prej tyre 50 trima djem e burra, të gatshëm për luftë në çdo kohë”.

Prej atëherë e deri më sot, Daka u përtëri në shumë breza. Është mirë ta njohësh prejardhjen. Ato familje që e kanë ruajtur vjetërsinë e familjes së vet, kanë mundur ta ruajnë traditën, që është investim disa brezash dhe pasuria më e madhe që familjarët ia përcjellin gjërit. Fisnik quhesh kur e shtyn historinë e familjes sa më larg në kohë. Për vetë rrethanat nuk ka qenë e mundur të ndriçohen brezat deri në kohën e plakut të madh të Dakës, kur mbledheshin më shumë se njëqind vetë nën një strehë të përbashkët. Delitë e sotëm mbajnë mend 12 breza, që përbëjnë 360 vjet kujtesë, prej Mal Dakës e në vijimësi: Deda, Neza, Gjergji, Ndoi, Delia, Qerimi, Marku, Marashi, Zefi, Henri. Ndonëse brezat e tjerë kanë humbur në thellësinë e kohës, gjurmët e tyre kanë mbetur në toponiminë e vendit që duhet shqyrtuar me kujdes.



**ISMET BALAJ JEP TË DHËNA ME INTERES PËR BLINISHTIN**

Ky fshat dikur shtrihej në teritore të gjëra që shtriheshin në Blinisht, Kabash, Bicaj, Qerret, Ukth dhe deri në Koman. Në anë të digës së sotme të hidrocentralit është një shkëmb, ku ngjitet një rrugë që të çon te një hyrje shpelle e quajtur “Shpella e Dakës” ose e Blinishtit. Kjo më shumë se pronësi tregon autoktoni, që do të thotë se blinishtasit ishin herët këtu dhe pastaj në rrethaa të caktuara u tkurrën dhe mbetën vetëm në Blinishtin e sotëm. Aty është toponimi Plaka, që sot shqiptohet më shpesh “Plakaj” me kuptimin “e vjetra, e plakura”, ku shtëpitë ishin afër njëra-tjetrës, siç kanë qenë qendrat e banuara të periudhës paraosmane, në peiudhën kur ende nuk kishte gjakmarrje në mes të banorëve dhe nuk kishin dalë ende armët e zjarrit. Me fillimin e gjakmarrjes humbi solidariteti tradicional midis banorëve dhe bashkjetesa u rregullua me norma të reja; banorët u vendosën larg njëri-tjetrit dhe menduan për sigurinë e familjes, duke zënë vende dominuese dhe të mbrojtura për banesat e tyre. U ngritën kullat prej guri të ndërtuara mbi shkëmbinj për të pasur themele të paluajtshme. Pas daljes së armëve të zjarrit, malsorët zvogëluar dritaret dhe i kthyen shtëpitë në kulla të fortifikuara, që ngjanin si kështjella të vogla me funksion mbrojtës.

Pas përmbysjes që solli pushtimi osman, në trevat shqiptare, ndodhën ndryshime të mëdha, u ndërpre një traditë e madhe fisnikërie dhe zhvillimi që po ecte në shtratin e kulturës europiane. Humbën Dukagjinët dhe Dakajt si mbështetës të tyre, por vazhdoi qëndresa në formën e mbi-

jetesës, me vendosmërinë për të qëndruar në vendin e të parëve, megjithë vështirësitë e shumta që krijoi pushtuesi osman. Pranë kullave, atje majë maleve u krijua toka e bukës. Vendi ishte i pjerrët, prandaj banorët në shpatina, pothuaj tërë gurë, kanë mbajtur dheun e tokës të mos ikte. Ruajtja e vendbanimeve, toponimeve, varreve, pra e gjithë asaj historie nën gërmadha, solli në vëmendjen e banorëve mitin e mbijetesës. Falë qëndresës së madhe të shqiptarëve doli në dritë dhe emri i njohur i fisit të Dakës, si derë bujare me emër në Pukë e më gjërë. I pari nga Dakajt që e riktheu atë traditë familjare në vëmendjen e njerëzve qe Deli Ndou, themeluesi i degës Delia të këtij fisi.

Studiuesi Ismet Balaj përmes akteve jetësore nxjerr në pah vlera të mëdha të familjes Delia. Që të quhesh familje e mirë duhet të kryesh akte mirësie, të paktën në një fushë të caktuar: të kesh shfaqur trimëri, urtësi, besnikëri ose bujari etj. Familjet e mira kanë mundur që të përballojnë situata të vështira, rastësore dhe të paparashikuara, duke bërë zgjedhje të vështira që kanë vënë në provë personalitetin dhe karakterin e burrave të tyre. Veprat e mira krijohen kur veprohet me drejtësi në një situatë që nuk e favorizon drejtësinë, kur sillësh me guxim në një rrethanë që paguhet shtrenjtë, sepse ndodhin në jetë disa ngjarje që e vënë burrin në provë dhe po të përballohen me sukses i japin vlerë shoqërore që mbahet mend ndër breza. Deli Ndou ka dhënë provime të vështira në jetën e tij, gjithnjë në mbrojtje të nderit dhe dinjitetit, pa cënuar askënd, por duke u përgjigjur sipas rregullave të kohës, kur të tjerë kanë dashur ta nëpërkëmbin. Natyrisht, kushdo ka nderin dhe dinjitetin e vet, por kur vjen puna për burrat e

një shpie të përmendur, nderi dhe dinjiteti vetjak fiton vlerë të veçantë. Në atë kohë burri nuk fyhej, nderi nuk cënohej, fjala nuk lëshohej pa menduar mbi kuptimin e saj, sepse shoqëria ishte shumë e ndjeshme ndaj të keqes dhe mbështeste atë që nuk e krijon, por dhe që nuk e duron të keqen. Kur dikush e pësonte nga ndonjë ngjarje e keqe rastësore thuhej në popull “e pat rrezik”, dhe kur qëndronte thonin “iu dha qëndresa”, apo “i pat hije pushka”. Në këtë rast personit dhe shtëpisë së tij i rritej nderi, emri i shkonte larg dhe rritej në rangun shoqëror. Ringritja e Shpisë së Dakës përmes Deli Ndout është e vështirë, heroike, me shumë sakrifica dhe vullnet dhe si e tillë dhe shumë e vlerësuar nga opinioni shoqëror. Delia u ngrit me ndihmën e miqve dhe shokëve më të mirë, prandaj ai e ngriti në kult miqësinë dhe shoqërinë. Me miq e shokë të mirë, familja kapërceu edhe dallgët e tjera të jetës.

Pas rënies së Dakës, me Delinë filloi ngjitja e një dege të trungut të Dakës, një ngjitje që u bë me vepra të mira që lanë gjurmë, prandaj emri i Delisë u përjetësua në formë mbiemri. Pas Dakës së Madh, Deli Ndou është i dyti burrë i njohur që mbeti në kujtesën historike në formë të mbiemrit. Është një mënyrë për të përjetësuar traditën dhe për ta përcjellë më lehtë ndër breza. Gjithkush interesohet për domethënien e mbiemrit të vet, dhe e quan si pikë fillestare në ndërtimin e pasaportës në mjedisin shoqëror dhe miqësor. Në Malësi mbiemri është i njaftueshëm për njohje. Çdo njeri duhet ta dijë se nga vjen dhe ku shkon, çfarë vlerash i kanë lënë të parët e tij, me të cilat mund të mburret dhe të respektohet.

Është shumë zor që të shohësh dritë në fundin e tunelit, kur e mendon se për të vajtur deri atje nuk të ndihmon askush, siç kishte ndodhur me Deli Ndoun. Por e kishte ndarë mendjen dhe kishte grumbulluar të gjitha energjitë e tij shpirtërore për të dalë prej së keqes. E kishte prekur fundin dhe priste vetëm të ngrihet. Por, ngritjet kërkojnë mundime të mëdha, të cilat Delia, e shoqja dhe fëmijët nuk i kursyen, deri sa ia dolën të fitojnë një betejë të madhe, luftën për jetën, të cilën e kishin fituar pak njerëz, pasi mendimi i përgjithshëm ishte që në atë vend nuk ke çfarë të ndryshosh. Sekret i punës së tij ishte munda, përpjekja, lufta për mbijetesë. Vitet që pasuan qenë më të mira. Çdo muaj sillte një arritje të re dhe familja i gëzohej punës me djerën e vet.

Delia ruajti marrëdhënie shoqërore dhe miqësore me njerëzit dhe ruajti me fanatizëm traditën e mikpritjes, besës dhe burrërisë së Derës së vet. Prej besimit në këtë familje, njerëzit i merrnin për të zgjidhur ngatërresa të vështira për t'u zgjidhur.

Delitë punuan fort për të arritur në të mirën e mundshme përmes punës dhe djersës së tyre. Prof. Ismeti jep të dhëna interesante për punën e kësaj familje në kushtet të papërshtatshme. Ndër shekuj ata iu kushtuan blektorisë dhe bujqësisë, burimeve të vetme ekonomike që kishte në krahinë e Pukës në atë kohë. Veprimtaria ekonomike e mbështetur mbi bujqësinë dhe blektorinë kërkonte shumë krahë pune që një shtë-

pi me pak pjestarë nuk mund ta bënte. Prandaj Delitë e ndjenë nevojën të jetonin nën një strehë të madhe dhe shkuan deri në 57 vetë. Për të përballuar detyrat kishte ndarje të punës brenda familjes. Shtëpia funksiononte si një fermë bujqësore dhe blektorale. Në atë shtëpi të madhe, me gjendje të mirë ekonomike shpenzohej me shumicë gjithçka, prandaj ishin të lidhur shumë me tregun.

Dikur familja dhe shoqëria shqiptare mbështetej kryesisht në mësimet që vinin nga tradita. Pasardhësit ishin të detyruar që t'u përmbaheshin rregullave të krijuara vite më parë nga paraardhësit e tyre. Tradita ruhej pa ndonjë mundim të madh. Në vend të bibliotekave familjare njerëzit mësonin përmes trashëgimisë gojore, që përcillej afër oxhakut nga gjyshi te nipi në vijimësi. Por, me zhvillimet urbane njerëzit filluan të interesohen përtej vendbanimit të tyre, e të mësojnë më shumë se historinë e familjes, fisit dhe trevës së vet.

Dera e Delisë është përmendur për mikpritje, bujari, besë dhe pasuri. Mikpritja nuk është thjeshtë ndarja e një pjese të pasurisë për miqtë, por edhe si angazhim për ta nderuar mikun, për ta mbrojtur në shtëpi dhe deri sa të hynte në një shtëpi tjetër ose të arrinte në shtëpinë e tij. Duke pritur dhe përcjellur miq çdo ditë, Delitë morën përgjegjësi, duke u bërë garantë për sigurinë e jetës së tyre. Një tjetër problem ishte dhe ana ekonomike e pritjes së miqve, sepse varfëria ishte e pranishme kudo dhe praktika e grabitjeve ishte përhapur aq shumë. Edhe ata që kishin pasuri, në atë terren malor midis maleve të Pukës, ajo krijohej me vështirësi të mëdha dhe kërkonte mund dhe djersë.


Autori Balaj e trajton me kompetencë dhe profesionalizëm periudhën e Luftës N-Ç dhe atë të viteve të pasqirimit. Pukjanët ishin banorë të maleve të lira që nuk i ishin nënshtruar kurë pushtuesve dhe Puka qe bërë njëra ndër qendrat e atdhetarizmit ndër shekuj. Ndër familjet pukjane më të njohura për kontribut atdhetar përmendet familja e Delive të Blinishtit. Në situatën që kaloi vendi ynë, kjo familje zgjodhi si busull orientuese atdhetarizmin, mirësinë, humanizmin, drejtësinë. Ata ruajtën si ideal shqiptarinë dhe traditën e të parve të vet, dhe kjo u mjaftoi për të ecur mirë në jetë. Faktor me rëndësi në ecurinë jetësore të Derës së Delive ka qenë orientimi i duhur në jetë, në varësi të rrethanave jetësore. Ata nuk i kushtëzuan lidhjet familjare nga orientimet politike, por njëherësh u angazhuan në mbrojtjen e qëndrimeve të veta, si një familje fort e angazhuar në zhvillimet shoqërore të kohës. Delitë u bënë të pranueshëm për të tjerët, duke mbetur vetvetja, sepse ata u dhanë vlerën e vet marrëdhënieve njerëzore, miqësore dhe familjare, pavarësisht nga qëndrimet e politikës së kohës. Pasardhësit e Deli Ndout ishin mësuar ta kapërcenin vetëveten për të ndërë hallin e tjetrit, dhimbjet dhe shqetësimet e tij, ishin mësuar të sakrifikonin për tjetrin brenda familjes dhe jashtë saj, në kushërinj, bashkëfshatarë dhe deri për njerëz të panjohur.

Familja është një detyrë që zgjat tërë jetës dhe që kërkon shumë punë, përkushtim dhe sakrificë



LIBRI

ME VËSHTRIM NGA E ARDHMJA



- diçka që shumë vetë shpesh e harrojnë. Fuqia e familjes është e madhe: asnjë nuk mundet të shkëputet prej saj. Ajo është si një rrjet i padukshëm në të cilin çdonjëri është i lidhur me fije të padukshme me tjetrin. Shtëpia e Delive kishte gjithmonë pamjen e një një vendi edukimi. Individët e saj gjendeshin në ndikimin e vazhdueshëm të vendit ku jetonin dhe punonin. Oda e burrave ishte një institucion ku pjesëtarët e familjes i pleqnin çështjet e ndryshme jetësore, duke filluar nga ato të thjeshtat e deri tek ato më të ndërlikuara. Ç’është e vërteta, nëpër këto oda gjeneratat e reja mësuan mjeshtrinë e sjelljes ndër burra, vetë filozofinë e jetës, për të folur pak e saktë në kuvend. Në atë “Senat burrërie” fliste më i madhi dhe pastaj me radhë të tjerët, ndërsa të rinjtë duhet të dëgjonin. Në përditshmërinë e zbatimit të kësaj tradite stërgjyshore, të moshuarit përcillnin urtësi në brezat më të ri, që trajnoheshin për të dhënë provimin e burrëritit të tyre.

Në këtë libër lexuesi do të mësojë shumë gjëra me vlerë të periudhës që kemi lënë pas, përmes historisë së Delive të Blinishtit. Burri që ia ngriti edhe më shumë emrin familjes ishte Mark Qerim Delia. Shtëpia gjatë drejtimit të tij kishte rënë në vështirësi dhe ishte ngritur. Marku e dinte çdo të thotë të kesh hall, të biesh keq, të përcaktosh si dilet prej andej, etj. Por çdo vështirësi në jetë është përvojë që e ndihmon njeriun për të ecur përpara. Delitë ia dolën sepse ditën të shumëfishojnë forcat, të shtojnë tokën dhe bagëtitë, të sigurojnë vetë prodhimet bazë ushqimore dhe të veshmbathjes. Prodhuan edhe më tepër se u duhej dhe u lindi nevoja për treg. Në marrëdhëniet me tregun, zoti i shtëpisë së njohur të Delisë njohu më mirë Shkodrën, qytetarin shkodran me mentalitetin e tij të

përparuar, u njoh dhe me shkodranë me emër që më vonë rrethanat e sollën t’i kishte miq në shtëpi. Ai u bë i njohur në Pukë, Mirditë, Shkodër e më gjërë dhe kishte dhënë prova burrërie dhe heroizmi që herët. Ishte pjesëmarrës në çetën e Nikollë Currit gjatë luftës kundër turqeve për shpalljen e Pavarësisë Kombëtare në vitet 11011-11012. Luftoi edhe kundër serbëve dhe në atë luftë plagoset. Këngëtar i popullor e ka përjetësuar atë ngjarje me vargjet: “Pushka e Markut shpejt asht ndezë, ashtë ndezë në serbë e në malazezë...”

Si shtëpi atdhetare me emër, Dera e Delisë bëhet strehë e atdhetarëve të mëdhenj të viteve njëzet të shekullit të kaluar. Nën ndikimin e tyre, orientohet drejt të majtës nacionaliste dhe demokratike, në krah të atdhetarëve të shquar: Bajram Curri, Hasan Prishtina, etj. Me rikthimin e Zogut në pushtet, arrestohet dhe kalon disa kohë në burg.

Pushtimi fashist që një provë e madhe morale, pasi kasta politike e kohës e pranoi në masë pushtimin dhe shumë zyrtarë të shtetit shqiptar u ofruan pushtuesve shërbimet e tyre. Bashkëpunorët shqiptarë të fashistëve kishin paguar një kosto të madhe morale për bashkëpunimin e tyre, por nga ana tjetër, siguruan përfitime politike, duke u shpërblyer me funksione të larta dhe sidomos siguruan përfitime ekonomike. Ndryshe u soll masa atdhetare, që i priti fashistët me pushkë që me 7 prill 1937 dhe e filloi rezistencën që atë ditë.

**SHTËPIA E MARK QERIMIT U BË STREHË PËR ANTIFASHISTË TË NJOHUR**

Shtëpia e Mark Qerimit u bë strehë për antifashistë të njohur. Atje jetoi mësuesi atdhetar Jordan

Misja, Hero i Popullit, që bashkë me Perlat Rexhepin dhe Branko Kadinë shkruan epopenë e madhe të rezistencës dhe mësuesi atdhetar Abdullah Çanga. Marku priti dhe përcolli dhe antifashistë të tjerë, Heroin e Popullit Fahri Ramadani, pastaj Heronjtë e gjallë të luftës Tuk Jakova dhe Sadik Bekteshin, bisedat me të cilët qenë ndihmë për atë, që ta kuptonte më mirë situatën ndërkombëtare dhe atë brenda vendit. Në atë kohë, informacioni qarkullonte vetëm në qytete, ndërsa në fshat ai sillej me vonesë nga njerëzit që shkonin në treg, ashtu si e kuptonin ata dhe ndodhte që shpesh herë ishte i gabuar. Pastaj qëndruan dhe antifashistë të tjerë, si individë, në grupe të vogla ose dhe reparte të partizanëve.

Lëvizja antifashiste në Pukë filloi herët dhe që nga ajo kohë, antifashistët gjetën mbështetje nga Marku dhe krejt Delitë e Blinishtit. Në malet e Pukës u krijua çeta antifashiste e Pashk Currit dhe çeta Pukë-Mirditë.

Luftëtarët e këtyre çetave e patën shtëpinë e Mark Qerimit strehën e tyre të sigurtë.

Burri i zgjuar, Mark Qerimi luftoi me forcën e fjalës dhe të mendjes së vet kundër demagogjisë së pseudoatdhetarëve që për përfitime personale kishin kaluar në anën e pushtuesit. Nuk kishte ndodhur kurrë që të kishte pushtues të mirë. Çdo pushtues e shkel një vend për ta shfrytëzuar dhe për të përfituar, prandaj atdhetarët sakrifikojnë dhe jetën kundër të huajve të paftuar. Kur një oficer italian, i shoqëruar nga 10 karabinierë vijnë e kontrollojnë Blinishtin në ndjekje të Jordan Misjes, Marku u thotë: “Unë due të jem i lirë në shtëpinë time. Duhet të shkonim në shtëpinë tuaj se ka me ardhë një tjetër ma i fortë dhe ju keni me ikë me faqe të zezë”.

Si burrë i zgjuar ai e ruajti të pacënuar kultin e mikut, edhe pse ndonjëri nga miqtë e tij zgjodhi rrugën e gabuar të bashkëpunimit me pushtuesin. Kjo bëri që atij t’i besojnë të dy palët që mblidheshin për të bërë debat, në përpjekje për të gjetur pikat e përbashkëta. Askush nuk doli pa u respektuar nga ajo shtëpi, askush nuk u ndje i pasigurt kur gjendej aty dhe të gjithë ata që e respektonin miqësinë e kishin derën hapur. Mark Qerimi la peng fjalën, që ishte vlerë e madhe.

Në besën dhe fjalën e Mark Qerimit pajtoheshin hasmëri dhe ngatërresa. Kushdo që i dorëzohet, nuk do të keqtrajtohej. Falë tij, shumë njerëz iu kthyen jetës normale në shtëpitë e tyre.

Marku kishte qëndrim dashamirës ndaj të gjithëve. I gatshëm për të ndihmuar gjithkënd që kishte të drejtë, gjithkënd që shprehte pendesë për gabimet e kryera, apo që kërkonte gjykim të drejtë për fajet e kryera. Sjelljen e njerëzve e gjykonte nga këndvështrimi moral dhe sipas traditës. Për atë, marrëdhëniet në shtet janë si në familje, ku njerëzit mblidhen rreth të zotit të shtëpisë. Marku nuk mbështeste individë, por alternativa.

Me ardhjen e forcave partizane, në shtëpinë e Markut u vendos shtabi i Brigadës XXII Sulmuese Partizane dhe spitali partizan. Ndërkohë, djali i madh, Ndreka dhe vëllai, Pali rrjeshtohen në formacionet partizane. Pukjanët i pritën

krahëhapur partizanët, besa e shtatë bajrakëve që disa krerë, bashkëpunëtorë të fashizmit u kishin dhënë pushtuesve, nuk funksionoi me popullin. Megjithatë, për shkak të traditës, thyerja e besës nuk ishte e lehtë dhe mundësitë e hakmarrjes nga gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre ishin të mëdha.

Forcat gjermane e goditën nga një kodër në Zezaj kullën e Delive, por kulla i mbijetoi atij bombardimi, ndërsa operacione tokësore ndaj saj nuk u ndërmorën, sepse armiqtë nuk kishin forca të mjaftueshme, për këtë qëllim. Ata e dinin se ajo kullë mbrohej nga partizanët. Për një muaj rrjesht familja Delia jetoi me partizanët dhe u vu në dispozicion të luftës çlirimtare. Forcat partizane shkonin e luftonin, pastaj ktheheshin aty, ku pushonin dhe mjekonin plagët. Marku që zgjedhur kryetar i Këshillit N-Ç të zonës dhe drejtonte punën për sigurimin e ushqimeve për partizanët. Kontributi kryesor me këtë rast u dha nga shtëpia e tij.

Me 20 nëntor, në qëndër të Pukës u mblodhën partizanë e qytetarë. Në një atmosferë feste u dha lajmi se Puka u çlirua. Në podiumin e improvizuar dolën drejtuesit e luftës antifashiste, burra të njohur si: Elez Hoxha, Nuri Llazani, Ali Bytyçi, Idriz Meti, Zenel Islami, Zef Gashi, Zef Miraka, Mark Dodani etj., dhe krah tyre Mark Qerimi që mbajti edhe fjalën e rastit në atë moment historik.

Nga leximi i këtij libri mësojmë se burri i njohur Mark Qerimi nuk ka shmangur në asnjë rast detyrimet shoqërore që kishte.

Me atë, familja e madhe e Dakës, ndër më të njohurat në Pukë, i qëndroi besnik atdheut edhe në ditë të ligë. Miqtë e familjes së Mark Qerimit në vitin 1945 u gjendën me miq në dy llogore të kundërta. Situata në Pukë në këtë periudhë ishte e vështirë. Ndarja shoqërore u bë mbi baza politike. Në malësitë shqiptare largimi i pushtuesve nuk u dha fund armiqtësive. Fillimisht rreth forcave që kundërshtuan pushtetin e pasluftës u mblodhën ata që kishin luftuar kundër partizanëve para çlirimit dhe për arsye të ndryshme nuk deshën të dorëzoheshin. Më vonë atyre iu bashkuan të tjerë, nisur nga motive krejt të ndryshme: njerëz që prekeshin nga reformat e sistemit që po vendosej; të tjerë që kundërshtuan çarmatosjen në kushtet kur malsorët nuk kishin pranuar kurë të çarmatoseshin as në kohën e Turqisë; kuadro të pushtetit të ri që kryenin detyra me përgjegjësi, por për besë, miqësi, lidhje gjaku, etj, kaluan në kampin tjetër. Çfarë duhej bërë në atë situatë? Delitë e kishin kuptuar një dobësi të madhe të regjimit socialist: karakterin anti-njerëzor të ndarjeve e përçarjeve, prandaj iu përkushtuan punës dhe nderuan miqtë e tyre, pavarësisht se në çfarë pozicionesh gjendeshin.

Mark Qerimi u aktivizua në jetën shoqërore në periudhën kur po forcohej shteti, por edhe ndikimet kanunore kishin rolin e tyre. Kërkoheshin burra të urtë dhe vullnetmirë që njihnin ligjin dhe kanunin. Duheshin gjetur forma për t’i bindur njerëzit dhe

për të bërë që ata të mos ruajnë pakënaqësi ndaj njëri-tjetrit. Nga ana tjetër, kishte shumë raste, kur njerëzit kërkonin ndërmjetës për të ndërhyrë pranë organeve shtetërore për të filluar një punë, për të nxjerrë një të drejtë studimi ose bursë, ose për të zgjidhur probleme nga më të ndryshmet.

Jeta ishte luftë dhe malsorët duhet ta fitonin atë. Flitej shumë për kapërcimin e vështirësive dhe shoqëria shqiptare sakrifikonte shumë në emër të së ardhmes. Ishte koha kur ende nuk ishin zhdukur sëmundjet ngjitëse, kur nuk ishte siguruar vaksinimi i popullsisë, kur nuk ishin siguruar as kushtet minimale në punë, kur ende nuk kishte shërbim mjekësor për të gjithë. Ishte koha kur akoma nuk ishte zhdukur uria dhe njeriu duhet të shtyhej në jetë dhe të mësonte të jetonte në mes të mungesave, por gjithësesi ishin vitet e një ndryshimi të madh. Edhe Puka po kalonte nga një shoqëri e mbyllur patriarkale drejt shoqërisë shqiptare të kohës, ende të varfër, me një barrë problemesh, por më dinamike e të hapur në kushtet e sakrificave. Ishte një gjendje e natyrshme progresi që e kërkonte koha. Në vitet e pasçlirimit, në fillim arritjet qenë të dukshme.

Njerëzit punonin për vete, merrnin rrogë në shtet, kishin dhe pronë në fshat, etj. Marku jetoi në periudhën e parë të transformimeve shoqërore, atë të rindërtimit dhe të ndryshimeve të thella shoqërore. Në atë kohë pukjanët dhe malsorët në përgjithësi kërkonin gjërat më themelore të jetesës: drithin dhe kripën, shkollën dhe spitalin, të cilat rendi i ri shoqëror i siguroi me përparësi. Kjo bëri që Marku të jetë i kënaqur me arritjet dhe në paqe me veten, pasi si veprimtar i njohur antifashist, këto arritje që ishin bërë realitet i kishte propaganduar gjatë luftës.

Marku nuk u bë komunist, por mbeti veprimtar i shquar shoqëror dhe mbështeti të gjitha nismat që i shërbyen zhvillimit të vendit. Ai u zgjodh në organet drejtuese të Frontit, në rreth, Qark dhe anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Si edhe më parë, jetesën familjare e mbështeti mbi punën e vet dhe të familjes. Vazhdoi të dallohet në punë dhe si atdhetar i njohur e bujk i dalluar mori pjesë në një delegacion të Ministrisë së Bujqësisë në Bashkimin Sovjetik për afro tre muaj.

Ai i donte bashkëfshatarët e tij dhe u identifikua me Blinishtin, Kabashin, Pukën si mishërim i burrit të traditës që trashëgon vlera, por është gati të pranojë të renë që ndihmon ecjen përpara. Kjo bëhej jo vetëm përmes bisedave të zakonshme, apo kur zhvillonte kuvendime odash, por edhe në veprimtaritë shoqërore në rang rrethi dhe në shkallë kombëtare. Markut i kishte hije pamja dhe fjala që shkonin në harmoni ndërmjet tyre. Marku kërkonte që njerëzit të ecnin me kohën, pasi vetë zhvillimet shoqërore i diktojnë njeriut nevoja dhe interesa të reja. Zhvillimet e reja kërkojnë mendësi të re dhe ndikojnë që ato mendësi të përdoren në të mirë të individit dhe shoqërisë.



VIZITA

## Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, vizitë dyditore të sukseshme në Ankara

**M**inistrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka zhvilloi një vizitë dyditore në Ankara, me ftesë të homologut të saj, ministrit të Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, z. Nurettin Canikli.

Ministri Canikli e priti zonjën Xhaçka me truporë nderi dhe ceremoni ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë.

Në takimin e ministres Xhaçka me homologun e saj turk, veç marrëdhënieve shumë të mira mes dy vendeve, u diskutua edhe për bashkëpunim dypalësh në industrinë ushtarake dhe të mbrojtjes.

Ministrja Xhaçka e falënderoi homologun e saj turk për ndihmën dhe mbështetjen e Turqisë për Forcat e Armatosura shqiptare, kryesisht sa i përket modernizimit, arsimimit ushtarak, kujdesit shëndetësor, por edhe stërvitjeve.

Pas takimit me ministrin Canikli, zonja Xhaçka vlerësoi klimën e mirë të bisedimeve me homologun e saj turk, i cili ofroi gatishmërinë e të plotë të vendit të tij për mbështetjen e mëtejshme të Forcave tona të Armatosura. “Diskutuaam lidhur me bashkëpunimin aktual ushtarak për trajnimin, arsimimin e përbashkët. U dakordësuam për mundësitë e shumta, të cilat do eksplorojmë dhe mora mbështetjen maksimale nga kolegu im Canikli për plotësimin e çdo kërkesë nga Shqipëria. Edhe për modernizimin e FA gjeta mbështetjen maksimale për çdo projekt, i cili do të gjykohej i nevojshëm për t’u zhvilluar. Me homologun turk pata veçse dakordësi për të zhvilluar kapacitet ushtarake. Trajtimi mjekësor i personelit ush-

# Shqipëri – Turqi: Bashkëpunim dypalësh në industrinë ushtarake dhe të mbrojtjes



tarak në Turqi do të vazhdojë dhe do të shtohet për të plotësuar të gjitha nevojat shëndetësore mjekësore, të cilat nuk i përmbushim dot në Tiranë.” - u shpreh ministrja Xhaçka, e cila takoi edhe studentët shqiptarë që studiojnë në akademitë ushtarake turke. Zonja Xhaçka u uroi suksese studentëve shqiptarë dhe u shprehu atyre rolin dhe rëndësinë e tyre brenda Forcave të Armatosura, sapo ata të përfundojnë studimet. “U konfirmova studentëve tanë që shkollohen në akademitë ush-

tarake turke që, do të vazhdojnë të jenë ndër shembujt e mirë të disiplinës

dhe profesionalizmit dhe presim prej tyre që të vijnë dhe të bëhen pjesë solide e piramidës sonë ushtarake.” - tha Xhaçka.

Në vijim të vizitës së saj, ministrja Xhaçka vizitoi disa fabrika të industrisë ushtarake dhe u njoh nga afër me mjetet, pajisjet dhe armatimet që prodhohen aty.

Gjithashtu ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë u prit në takime të veçanta nga ministri i Brendshëm i Turqisë z. Süleyman Soyulu dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura turke, gjeneral me katër yje Hulusi Akar.

Në takimet me zyrtarët e lartë turq, ministrja Xhaçka diskutoi për çështjet e interesit të përbashkët në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Pjesë e vizitës zyrtare të ministres Xhaçka, ishin edhe homazhet dhe vendosja e një kurore me lule në Anıtkabir, Mauzoleun e Mustafa Kemal Atatürk.

## 97 vjet Xhenio dhe Artileri, Xhaçka: 25 mijë banorë kanë ura e rrugë të reja falë kontributit të FA

Batalionet e Xhenios dhe të Artilerisë, 97 - vjetori i krijimit i gjeti në terren përmes kontributit të drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetës së qytetarëve në çdo zonë të Shqipërisë. Në ceremoninë e posaçme, të organizuar në Batalionin e Xhenios (bxh) të Komandës Mbështetëse të FA, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka risolli në vëmendje arritjet e efektivëve të xhenios gjatë situatës së emergjencës civile dhe ndërhyrjeve të tyre të frytshme në çdo moment ku ka pasur vështirësi.

“Vetëm në tre muajt e fundit, efektivët e Batalionit Xhenio i kanë ardhur në ndihmë mbi 25 mijë banorëve në zona problematike duke ndërtuar 12 ura. Por jo vetëm kaq, njësitë edhe reparatet xheniere kanë marrë pjesë në riparimin e rrugëve, në tharjen e kënetave, në ndërtimin e kanaleve bonifikues, argjinaturave, hidrovorëve ujësjellësve, eliminimin e pasojave të fatkeqësive natyrore si tërmetet dhe përmbytjet, pa harruar edhe ndërtimin e tuneleve dhe bazave tona ushtarake. Përballimi me sukses i emergjencave civile në ditët e para të muajit dhjetor ishte një tregues më i mirë se Forcat e Armatosura janë në krye të detyrës në çdo moment, me atdhedashuri dhe me përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj punës. Gjatë ditëve të emergjencës civile



efektivët e xhenios nuk dhanë ndihmën e tyre vetëm në infrastrukturë, por janë gjendur pranë banorëve duke shpërndarë ndihmat e mbledhura.

“Krahas kontributit në ndërtimin e urave në kohë rekord efektivët e Komandës Mbështetëse, shpërndanë mbi 800 ton produkte ushqimore dhe blegtorale në 6 bashki. Më shumë se 5 mijë familje u asistuan nga efektivët e FA për të kapërcyer pasojat e përmbytjeve.” - tha Xhaçka.

Në prani të efektivëve të dy batalioneve dhe të ish - efektivëve xhenio dhe artiljerë, ministrja e Mbrojtjes nënvizoi modernizimin e Forcave të Armatosura, si prioritetin kryesor të 4 viteve të ardhshme.

## Gjeneral brigade Manushaqe Shehu emërohet zëvendësshefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA



Gjeneral brigade Manushaqe Shehu emërohet zëvendësshefe e Shtabit të Përgjithshëm, duke u bërë kështu grua e parë që shërben në një detyrë kaq të lartë në Forcat e Armatosura Shqiptare. Zëvendësshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Shehu më parë shërbeante në detyrën

e komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe zëvendëson në detyrë gjeneral brigade Dedë Prengën, i cili emërohet zëvendëskomandant i Forcës Tokësore.

Vendin e lënë bosh nga gjeneral brigade Shehu në krye të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, e zë gjeneral brigade Bajram Begaj, i cili është mjeku i parë ushtarak shqiptar që mban gradën gjeneral brigade.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka në ceremoninë e prezantimit të dretuesve të rinj vlerësoi kontributin dhe përvojën e tre ushtarakëve të lartë dhe shprehu bindjen se tre gjeneralët do të përmbushin më së miri pritshmëritë në detyrat e reja.


## NDERIMI

## Kosova përkujton Presidentin, 12 vjet pa Ibrahim Rugovën

Në përkujtim të 12 vjetorit të ndarjes nga jeta e ish-Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, presidenti aktual Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës bënë homazhet para varrit të tij. Ibrahim Rugova u zgjodh më 23 dhjetor 1989, kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, partisë së parë politike në Kosovë që sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi. Rugova ndërroi jetë më 21 janar 2006.

Presidenti aktual i vendit, Hashim Thaçi, ka vizituar ditën e dielë më 21 janar 2018 varrin e ish-presidentit Ibrahim Rugova, në përkujtim të 12 vjetorit të ndarjes nga jeta. Thaçi, së bashku me disa pjesëtarë të kabinetit të tij, si dhe kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj kanë kryer homazhet në nderim të ish-Presidentit historik të Kosovës.

Të pranishëm në memorialin e Rugovës, ishin edhe anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e para parti e Kosovës që nën drejtimin e Ibrahim Rugovës, sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi në 1989. Hashim Thaçi tha se brenda një periudhe dhjetëvjeçare, Rugova udhëhoqi një politikë të rezistencës paqësore, duke shprehur vullnetin e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi, me orientim nga vlerat perëndimore.



Presidenti aktual nënvizoi se nuk do të mungojnë kurrë nderimet institucionale për kontributin dhe angazhimin e Rugovës për liri dhe pavarësi të Kosovës. Ndërsa kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj tha se do ta kujtonte gjithmonë me respekt shembullin, figurën dhe vizionin e të ndjerit Ibrahim Rugova. Në përvjetorin e parë të vdekjes së Ibrahim Rugovës, ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, e dekoroi Rugovën me Urdhrin “Hero i Kosovës”, titulli më i lartë në vendin tonë që u jepet figurave historike shqiptare dhe të Kosovës. Dr. Ibrahim Rugova lindi më 2 dhjetor të vitit 1944 në fshatin Cerroë, komuna e Istogut. Më 10 janar 1945 komunistët jugosllavë ia pushkatuan të atin, Ukën dhe gjyshin Rustë Rugovën, që kishte qenë luftëtar i njohur kundër çetave çetnike që po depërtorin në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore.